



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 18 MAJ 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 18. MAJA 2015. GODINE**

**MAJ - MAJ
2015**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përgjimin e telekomunikimeve,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

Dnevni red

1. Prvo razmatranje Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona o sudovima,
2. Prvo razmatranje Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona o Sudskom savetu Kosova.
3. Prvo razmatranje Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona o Tužilačkom savetu Kosova,
4. Prvo razmatranje Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona o državnom tužiocu
5. Prvo razmatranje Nacrt zakona o prisluškivanju telekomunikacija,
6. Prvo razmatranje Nacrt zakona o naknadi žrtava zločina.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Para se të fillojmë këtë pikë të rendit të ditës, i kisha lutur deputetët për arsye se njëri nga deputetët nënshkrues Deklaratës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës ka vdekur që ta mbajmë një minutë heshtje për ish-deputetin, Zylfi Mërgja.

(Një minutë heshtje)

Nderime!

Atëherë i hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 12 maj 201, ka vendosur që t'i propozojë Kuvendit që shqyrtimi i gjashtë projektligjeve më poshtë të bëhet me procedurë të përsheptuar - shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, si në vijim.

Për shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 56, paragrafi 1 dhe neni 57, paragrafët 3,8 dhe 9 të Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve, të cilat janë gjashtë nga projektligjet që anë të bëjnë drejtpërdrejt me liberalizimin e vizave, shqyrtimi i parë i projektligjeve të bëhet në seancën e sotme plenare më 18 maj 2015. Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme deri më 25 maj 2015 duhet t'i shqyrtojnë projektligjet dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime për shqyrtim të dytë në seancë plenare.

Shqyrtimi i dytë i projektligjeve të bëhet në seancën plenare, më 28 maj 2015.

Kërkohet deklarimi i grupeve parlamentare. Nga Partia Demokratike e Kosovës, në qoftë se ka dikush të deklarohet?

Atëherë për t'iu shmangur Rregullores. Glauk, urdhëro të lutem!

GLAUK KONJUFCA: E kam theksuar edhe në Kryesinë Kuvendit se ne po na ndodh këtu në Kuvend të Kosovës një problem konstant. Cili është ky problem? Problemi është me vonesa të vazhdueshme që po na vijnë prej zyrtarëve publikë të Republikës së Kosovës, zyrtarëve qeveritarë, të cilët kanë marrë edhe obligime dhe e kanë përgjegjësi për t'i shtyrë sa më shpejt edhe proceset e integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian, por ndaras prej kësaj, që është një proces shumë teknik, është procesi i liberalizimit të vizave.

Mos harroni që Komisioni Evropian prej dhjetorit të vitit 2009 ka thënë që e kemi iniciuar procesin e dialogut me qeveritarët e Kosovës për liberalizimin e vizave. Pra, po bëhet viti i gjashtë prej kur qeveritarët tanë negociojnë me Komisionin Evropian për liberalizim të vizave dhe liberalizimi i vizave nuk është askund. Dhe, çka po na ndodh ne në Kuvend? Prej vitit 2011

ne miratojmë pako e pako të tëra ligjesh me arsyetimin se kjo është pakoja e fundit, e cila na duhet për të na ardhur liberalizimi i vizave.

Ne në këtë Kuvend kemi qenë edhe vetë si deputetë në mandatin e kaluar. Unë e mbaj në mend me Ligjin e azilit, me Ligjin e letërnjoftimit, me Ligjin për kontrollin e kufijve me dhjetëra ligje kanë ardhur këtu në Kuvend në formë të pakove, duhet të miratohen me procedurë të përshpejtuar, sepse kjo do të na çojë në liberalizimin e vizave.

Liberalizimi i vizave nuk na erdhi, por na erdhi kjo pakoja e ardhshme tash, që u dashka ta miratojmë me procedurë të përshpejtuar për të hyrë në procesin e liberalizimit të vizave. Kjo është joserioze, jo për këtë arsye, por edhe vetë në agjendën legjislative të Kuvendit të Republikës së Kosovës këto ligje kanë pasur të vijnë më 31 mars. 31 marsi ka qenë data e fundit, afati i fundit kur është dashur të vijnë këto ligje. Shikojeni agjendën legjislative, aty e keni datën dhe nuk kanë ardhur, e ne po vonohemi një muaj. Tash, në vend që t'i shqyrtojmë, ta kemi atë një muaj për t'i shqyrtuar në mënyrë kualitative këto ligje, ne detyrohemi t'i bëjmë për dy apo tri ditë për t'i shqyrtuar këto ligje dhe kur i ke vetëm dy apo tri ditë nuk ka kurrësi si të dalin kualitative në shqyrtim nga deputetët. Kjo është një kritikë tjetër.

Dhe, çështje tjera që dua t'i ngre në këtë rast edhe sa i përket këtij procesi, që po na thuhet të liberalizimit të vizave - shikojeni, ne e kemi marrë udhërrëfyesin për liberalizim të vizave, Qeveria e Kosovës e ka marrë në qershor të vitit 2012, tre vjet po bëhen, e kjo do të thotë kriteret që janë marrë për t'i plotësuar Kosova ashtu që të na jepet liberalizimi i vizave.

Ku mendoj unë se ka ngecur puna më së shumti? Puna ka ngecur në disa prej këtyre kriterëve dhe unë po filloj prej bllokut të tretë, që quhet i kriterëve, e ky është blloku i luftës kundër korrupsionit.

Komisioni Evropian e ka thënë qartë aty në bllokun e tretë, pa luftim të korrupsionit nuk ka liberalizim të vizave, krimi i organizuar, pastrimi i parave, krijimi i institucioneve dhe mjeteve efektive për konfiskimin e pasurisë të paligjshme. Krejt këto ceken në këtë udhërrëfyes dhe unë mendoj që kot i kemi këto arsyetime të qeveritarëve se ne duke i miratuar këto ligje jemi më afër liberalizimit të vizave. Nuk është fare çështja te këto ligje.

Po shikojeni, për shembull, çka thonë kriteret te blloku i tretë për liberalizim të vizave. “Qeveria të mundësojë të realizohen hetimet proaktive të pasurisë së pazakonshme”, term i Komisionit Evropian që i bie domethënë “pasuria e pazakonshme, apo e dyshimtë” dhe çka do të thotë kjo “proaktive”. Proaktive do të thotë që institucionet gjyqësore nuk mund të presin që dikush të ankohet që pasuria e ndonjë zyrtari qeveritar është shumë e lartë, e pastaj institucionet gjyqësore të vihen në ndjekje të tij. Kjo do të thotë që vetë institucionet gjyqësore e kanë për detyrë t'i gjejnë këto raste. Për shembull, kur një politikan në vitin 2012 e deklaroi pasurinë 2 milionë euro, e në vitin 2013 e publikoi pasurinë e tij 3 milionë euro, 1 milionë euro më shumë, e në pasuri ka deklaruar vetëm se e ka shtëpinë e familjes dhe disa toka, domethënë nuk ka biznes aq të madh që të ketë dallim një milion euro që ta paraqesë pasurinë në vitin tjetër, gjyqësia menjëherë, po shkruan këtu në mënyrë proaktive, duhet të vendoset në funksion të gjetjes të kësaj që po shkruan “pasuri e pazakonshme, apo e dyshimtë”.

Shtrohet pyetja, a i ka kryer Qeveria këto kritere? Unë mendoj që Qeveria e Republikës së Kosovës, nëse e lexoni këtë udhërrëfyes të vitit 2012, është shumë larg realizimit të këtyre kritereve.

Dhe, mos harroni, aty kemi edhe shumë çështje të ndjeshme. Për shembull, te çështja e kufirit, thuhet: “Duhet të demarkohet kufiri me Malin e Zi, nëse doni liberalizim të vizave”. Dhe, shikojeni se çfarë po ndodh tash atje. Mali i Zi ka hyrë 3 apo 4 kilometra, e ka vendosur edhe patrullimin e tij, edhe praninë e institucioneve të veta brenda territorit të Kosovës, e në anën tjetër Qeveria e Kosovës po ngutet për liberalizim të vizave. A mos do të thotë kjo që mund të kemi pazare për kufirin e Kosovës për liberalizim të vizave. Unë do të doja që të mos ndodhte kjo.

Unë besoj që kjo do të merret me shumë kujdes, sepse ne nuk na duhet tash që për liberalizim të vizave, kjo nuk bëhet me asnjë kusht, as për çfarëdo kushti tjetër që Qeveria e Kosovës të bëjë pazare me shtetet përreth në dëm të kufijve të Kosovës, duke ia shitur këtë popullit si një nevojë që e kemi ne si Kosovë për liberalizim të vizave.

Do të thotë, ka shumë probleme të mëdha dhe më së pakti këtë çështje e zgjidhin një sërë ligjesh që na janë sjellë këtu me shumë shpejtësi dhe që janë shumë të rëndësishme, thënë të drejtën. Kanë të bëjnë kryesisht me çështjen të gjyqësisë, siç është për Këshillin Gjyqësor, për Këshillin Prokurorial të Kosovës, për Prokurorinë e Shtetit. Këto janë ligje kapitale. Këto janë tema shumë të rëndësishme dhe ne po na jepet një afat shumë i shkurtër për t’i trajtuar këto.

E gjitha kjo, në fakt, në të vërtetë flet më shumë për jo seriozitetin e kësaj Qeverie.

KRYETARI: Atëherë nga grupet parlamentare? Nuk ka tjetër diskutim. Për t’i shmangur Rregullores, Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm në mbledhje plenare.

Kërkohet deklarimi me votim për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për shqyrtimin e gjashtë projektligjeve.

Edhe një herë, për t’u futur së pari në diskutim, Albulenë, duhet votuar, a po futemi në diskutim, se s’kemi hapë asgjë, s’kemi materie. Atëherë përgatituni për votim. Kërkohet deklarimi me votim për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për shqyrtimin e gjashtë projektligjeve.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Sipas sekretarisë, 79 deputetë janë në sallë. Votojmë tash!

Në votim kanë marrë pjesë 76 deputetë, 61 deputetë kanë votuar për, 10 kanë votuar kundër dhe 5 kanë abstenuar.

Konstatoj se Kuvendi vendosi që shqyrtimi dhe miratimi i gjashtë projektligjeve të bëhet me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Po futemi në këto gjashtë projektligje:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përgjimin e telekomunikimeve

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL për Integritime Evropiane e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin dhe rekomandimet për shqyrtim dhe miratim në parim.

E ftoj ministrin e Integritimit Evropian, zoti Bekim Çollaku që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BEKIM ÇOLLAKU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

I nderuar kryeministër,

Sot po diskutojmë Projektligjin për përgjimin e telekomunikimeve. Ky projektligj siç e dini bënë pjesë në pakon e ligjeve të domosdoshme që ndërlidhen drejtpërdrejtë me procesin e liberalizimit të vizave.

Ky ligj rregullon procedurat dhe kushtet mbi përgjimin e telekomunikimeve që realizohen për nevojat e procedurës penale nga institucionet shtetërore të themeluara me ligj dhe procedurat dhe kushtet e përgjimit për nevojat e strukturat e inteligjencës të themeluara me ligj.

Krahas kësaj ligji përcakton rregullat, detyrimet dhe procedurat për operatorë të rrjeteve dhe ofruesit e shërbimeve në lidhje me përpunimin e të dhënave të caktuara nga ana e tyre.

Ligji është hartuar duke marrë parasysh Rezolutën e Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 17 janar 1995 mbi përgjimin ligjor të telekomunikimit.

Projektligji i ka përcaktuar edhe parimet themelore dhe udhëheqëse me rastin e përgjimit, të cilat janë:

- Respekti për të drejtat dhe liritë themelore të njohura dhe të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut nëpërmjet praktikës së saj gjyqësore.

- Ndalimin e përgjimit pa një vendim përkatës gjyqësorë. Përgjim i ligjshëm konsiderohet vetëm ai përgjim për të cilën është lëshuar urdhri i ligjshëm nga gjykata kompetente për të autorizuar përgjimin.

- Raporti ndërmjet qëllimit që synohet të arrihet dhe mundësisë së realizimit të këtij qëllimit me metoda tjera hetuese dhe se krejt objektivitetin gjatë kryerjes së përgjimit.

Pra, me rastin e vendosjes për një kërkesë përgjimi dhe përpara se të autorizohet përgjimi si masë hetuese ose mbledhjes së informacionit gjykata kompetente duhet të sigurohet që janë shteruar të gjitha masat tjera hetimore, ose të mbledhjes së informacionit.

Një aspekt shumë i rëndësishëm që ky ligj rregullon është mbrojtja e të drejtave dhe punës së gazetarëve.

Bazuar në Kushtetutën e Kosovës ku liria e shprehjes dhe e mediave garantohet dhe është standard i të drejtave të njeriut në një shoqëri demokratike Gjykata kompetente është e obliguar që të mbroj të drejtat e gazetarëve për ruajtjen e burimeve të informacionit dhe për mos zbulimin e burimit të mbrojtur të informatës së përcaktuar me ligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë dhe Kodin Penal të Kosovës.

Me përputhje me këtë projektligj procedura e vendosjes së përgjim të ligjshëm zhvillohet në tri faza të veçanta.

Parashtrimi i kërkesës për përgjim nga institucioni i autorizuar me ligj, shqyrtimi i miratimit dhe paraqitja e kërkesës për përgjim si dhe urdhri gjyqësorë për përgjim.

Një çështje tjetër që është adresuar në projektligj dhe që është temë e debatit për draftin e kaluar është ruajtja dhe shkatërrimi i të dhënave.

Në nenin 23 të këtij projektligji në mënyrë të qartë e sqaron se pas arritjes së qëllimit të dhënat nga përgjimet duhet të shkatërrohen.

Një ndryshim tjetër qenësorë dhe tepër i rëndësishëm që është arritur përmes këtij projektligji është ndarja e njësisë ndërlidhëse dhe qendrës të monitorimeve.

Njësia ndërlidhëse do të vendoset në Zyrën e kryeprokurorit të shtetit për derisa një qendër monitoruese do të vendoset në Policinë e Kosovës për të shërbyer për përgjime për qëllime të procedurës penale. Një qendër tjetër e monitorimit do të vendoset në Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë për të shërbyer për përgjime për qëllime të sigurisë kombëtare.

Me këtë ndryshim e kemi fuqizuar rolin e kontrollin dhe kemi siguruar një proces i cili po thuhet se bënë të pamundur hapësirën për keqpërdorime eventuale gjatë këtij procesi.

Përveç këtyre masave projektligji parasheh krijimin e komisionari për mbikëqyrjen e përgjimeve, i cili do të mbikëqyrë respektimin e ligjit me procedurën e përgjimeve.

Komisionari është një mekanizëm i vendosur në kuadër të strukturës institucionale të Këshillit Gjyqësorë të Kosovës.

Në rastet kur konstatohen shkelje Këshilli Gjyqësor i Kosovës i adreson ato në panelin për shqyrtimin e vëzhgimit dhe hetimit sipas Kodit të Procedurës Penale, kurse inspektori i përgjithshëm i adreson sipas kompetencave në bazë të ligjit për AKI-në.

Duke ju falënderuar për vëmendje dhe kontributin e dhënë në hartimin e këtij projektligji, ju propozoj që ta miratojmë në lexim të parë dhe pastaj për çdo sugjerim ose ndryshim eventual do të kemi mundësi ndërmjet dy leximeve.

Vetëm dua të ju sqaroj që një kontribut shumë të madhe në hartimin e këtij projektligj kanë dhënë organizatat e specializuara të shoqërisë civile të cilat në emrin tuaj dhe në emrin tim dua t'i falënderoj për kontributin e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Të nderuar deputetë,

Pas prezantimit të projektligjit, hap debatin për diskutimet në parim. Anëtari i Komisionit FunkSIONAL për Integritet Evropian, Ilir Deda ftohet ta marrë fjalën.

ILIR DEDA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Zonja e zotërinj,

Zoti ministër,

Komisioni për Integritet Evropian më datën 15 maj 2015 në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi në parim Projektligjin për përgjimin e telekomunikimeve dhe një zëri ka vendosur që Kuvendit t'ia paraqet rekomandimin për miratimin në parim të këtij projektligji.

Anëtarët e Komisionit janë marrë vesh që një zëri të dalin deri më 25 maj edhe me disa amendamente të përbashkëta dhe gjatë kësaj jave do të kemi mbledhje me të gjitha grupet e interesit që ky ligj më të fund të kalojë me datë të paraparë me afatet të cilat i kemi paraparë.

Tash e kisha shfrytëzua rastin të flas edhe në emrin e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes për ligjin.

Mund të them që ky ligj është jashtëzakonisht më cilësorë se sa atë që e kemi pasur në janar.

Shumica e vërejtjeve të Lëvizjes “Vetëvendosje” janë adresuar dhe ka pasur inkluzivitet shumë më të madh në hartimin e projektligjit të ri.

Ky ligj i merr parasysh standardet më të larta evropiane sa i përket mbrojtjes, privatësisë së qytetarëve, mbrojtjes së gazetarëve që është shumë me rëndësi, e specifikon qartë institucionet përgjegjëse të cilat mund të japin leje për përgjim dhe kjo është prokurori i shtetit diçka që nuk e kemi pasur në projektligjin e kaluar. Parashihet edhe institucionalizimi i komisionarit për mbikëqyrje të zbatimit të këtij ligji që është me rëndësi.

Vërejtjet të cilat i kemi kanë të bëjnë me ruajtjen e të dhënave pas përfundimit të procedurave, 12 muaj është një kohë shumë e gjatë dhe mendojmë se pas përfundimi të çdo procedure duhet që të ulet afati kohorë që ka të bëjë me shkatërrimin e të dhënave të përgjuara. A të njëjtën kohë duhet ... jo konsistencë në gjuhën shqipe dhe angleze sa i përket rolit të komisionarit sepse shkeljet të cilat ai mund t'i gjej në zbatim të ligjit duhet të jenë vepër penale, e ka pas një lëshim në gjuhën shqipe sa i përket këtij ligji dhe ne në Komision do ta adresojmë këtë.

Kemi edhe vërejtje teknike shumë më të vogla, po atë çka mund të them është që edhe një herë Lëvizja “Vetëvendosje” është pro ligjit do ta votoj në lexim të parë dhe do të dalim me

amendamente gjatë kësaj jave sepse ky ligj është jashtëzakonisht më i avancuar dhe më afër standardeve të cilat kërkohen që Kosova t'i zbatoj. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Partia Demokratike e Kosovës, Luljeta Gutaj-Veselaj e ka fjalën.

LULJETA GUTAJ-VESELAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritarë,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, përkrahim miratimin e Projektligjit për përgjimin e telekomunikimeve.

Jo vetëm pse ky projektligj bën pjesë në grupin për përmbushjen e kriterëve për liberalizim të vizave, por se para nesh e kemi një ligj të mirë i cili e rregullon një fushë shumë të ndjeshme.

Ndalimin e përgjimit pa një vendim përkatës gjyqësor si dhe respekti për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të njohura dhe të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut janë parime kryesore dhe shtylla të këtij projektligji.

Projektligji parasheh që përgjimi i ligjshëm konsiderohet vetëm ai për të cilin është lëshuar urdhër nga gjykata kompetente për të autorizuar përgjimin.

Krahas kësaj shqetësimi i këtij parlamenti për draftin e kaluar mbi ruajtjen e të dhënave është adresuar në nenin 23, i cili sqaron se pas arritjes së qëllimit të dhënat nga përgjimet duhet të shkatërrohen.

Krahas kësaj, projektligji parasheh themelimin e komisionarit për mbikëqyrjen e përgjimeve, si dhe bën ndarjen e njësisë ndërlidhëse dhe qendrës së monitorimeve. Duke pas të gjitha këto argumente parasysh përgëzoj ministrin Çollaku dhe Ministrinë e Integritetit Evropian, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe konfirmoj përkrahjen tonë për projektligjin si dhe ju ftoj të nderuar kolegë që ta votojmë Ligjin për përgjimin e telekomunikimeve si një obligim që afirmon sigurinë tonë kombëtare dhe progresin e vendit tonë drejt Bashkimit Evropian. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Milazim Haliti është këtu i lajmëruar. Urdhëroni!

MILAZIM HALITI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për përgjimin e telekomunikimeve i propozuar nga Ministria e Integritetit Evropian që është propozuar në lexim të parë edhe në seancën e 23 janarit të viti 2015, por me të drejtë deputetët i bënë vërejtjet e projektligjit i cili iu kthye ministrisë për ripunim. Në projektligjin që tani e kemi në diskutim ministria i ka bërë plotësimet e duhura duke u bazuar në vërejtjet e deputetëve që i dhanë në seancën e 23 janarit.

Projektligji është i hartuar mirë, duke u bazuar në Rezolutën e Këshillit të Bashkimit Evropian të 17 janarit 1995, mbi përgjimin ligjor të telekomunikimeve si dhe raportin e Komisionit Evropian për progresin e Kosovës ku ka potencuar kërkesën që Kosova ka nevojë për krijimin e një kornize ligjore për përgjimin e telekomunikimeve, si dhe të bëhet një dallim i qartë ndërmjet përgjimit gjyqësor dhe përgjimit për qëllime të inteligjencës e gjithë kjo për të shmangur ndikimin e mundshëm politik në çështjet penale dhe për të siguruar mbikëqyrje adekuate gjyqësore.

Dispozitat e këtij projektligji parashohin ndarjen e përgjimit për nevoja të procedurës penale dhe për nevoja të strukturave të inteligjencës dhe të sigurisë kombëtare. Gjithashtu, përcakton rregullat dhe procedurat për operatorët e rrjeteve dhe ofruesit e shërbimeve në lidhje me përpunimin e të dhënave si dhe përcakton detyrimet e institucioneve shtetërore. Projektligji saktëson drejtë dhe mirë parimet themelore me rastin e përgjimit duke i respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut.

I ndalon përgjimet pa një vendim të gjykatës duke paraparë si përgjim të ligjshëm vetëm atë për të cilën është lëshuar urdhri nga gjykata kompetente. Parashihet edhe klasifikimin e llojeve të përgjimit që është risi në këtë që është vetëm prokurori i shtetit ai i cili është i autorizuar për të parashtruar kërkesë për përgjim të ligjshëm ndërsa institucionet tjera të autorizuar për të parashtruar kërkesë për përgjim të prokurori i shtetit me qëllim të procedurës penale janë Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore dhe misioni i OSBE-së për sundim të ligjit.

Janë të klasifikuara edhe qendrat e monitorimit që janë paraparë të jenë në Policinë e Kosovës për përgjim për qëllim të procedurës penale dhe në Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë për përgjimet e telekomunikimeve për qëllime të inteligjencës dhe sigurisë kombëtare.

Është definuar drejtë ruajtja dhe shkatërrimi i të dhënave duke i paraparë edhe afatet e ruajtjes dhe shkatërrimit nën përkujdesjen e kryeprokurorit të shtetit dhe të inspektorit të përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, që kanë të bëjnë me AKI. Po ashtu, parashihet edhe Komisioni për Mbikëqyrjen e procesit të përgjimeve të telekomunikimeve i cili është risi edhe i cili ushtron kontroll të rregullt vjetor mbi ligjshmërinë e procesit të përgjimeve nga institucionet e autorizuar me këtë ligj.

Projektligji nuk do të ketë as kosto shtesë financiare gjatë ri hartimit të projektligjit është bërë plotësimi i variantit të parë, janë marrë parasysh edhe vërejtjet e theksuara nga deputetët, si dhe është domosdoshmëri që Kosova të ketë projektligjin. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah në parim miratimin e këtij projektligji dhe do ta jap kontributin në fazën e amendamentimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Time Kadrijaj, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Ky projektligj tash që ka ardhur në Kuvendin e Kosovës është një projektligj më i avancuar në krahasim me projektligjin tjetër që me të drejtë deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk e kanë votuar, por e kanë kthyer në Qeveri për amendamentim.

Ky projektligj përcakton rregullat dhe procedurat për operatorët e rrjeteve dhe ofruesit e shërbimeve në lidhje me përpunimin e të dhënave të caktuara. Parimet kryesore të këtij projektligji apo parimet themelore janë: respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, privatësia, shkatërrimi i të dhënave, mbrojtja e të drejtave të gazetarëve.

Ndalimi i përgjimeve pa një vendim përkatës gjyqësor që do të thotë është vendos se kush jep urdhër për përgjime dhe kush jo. Të mos përsëritet rasti që e kemi pas aferën e fundit në fund të fundit me këtë projektligj po legalizohet edhe afera “printo”, të caktohet cilat janë llojet e përgjimeve dhe për çka po, për cilat nevoja po aranzhohen këto përgjime, procedurat, përgjimet për nevojat e strukturave të inteligjencës dhe sigurisë kombëtare, procedurat e vendosjes për përgjim por është e caktuar edhe kush do i mbikëqyr të gjitha. Ne si komision, por edhe si grup parlamentar e kemi vërejtjen në kohëzgjatjen dhe ruajtjen e të dhënave, gjë që në projektligj është specifikuar se duhet të jetë një vit, mirëpo besoj që gjatë amandamentimit në komisionin parlamentar do ta japim kontributin që ky projektligj le të jetë një projektligj i mirë.

Ne si grup parlamentar do e votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Nisma”, Haxhi Shala e ka fjalën.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet të gjithë deputetët,

Qytetarët e Kosovës,

Edhe ne si Grup Parlamentar “Nisma” do ta përkrahim në parim këtë ligj, sepse është një ligj i cili është më i avancuar se ligji i mëhershëm i cili ka proceduar në janar në Parlamentin e Kosovës.

Ne i kemi vërejtjet e tona, besoj që nesër në Komisionin për Integritet do t’i japim vërejtjet me shkrim dhe do t’i prezantojmë edhe para ministrave, dhe para komisionit. Atë që e kemi vërejtur nuk është cekur roli i mbikëqyrjes së Parlamentit në këtë ligj, është mirë të precizohet roli i Parlamentit në mbikëqyrjen e këtij ligji. Kështu që në parim ne do ta përkrahim si grup parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kujtim Paqaku nga Grupi “6+”, e ka fjalën.

KUJTIM PAQAKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në tërësi e përkrahim, sepse shohim se respektohen të drejtat e njeriut në përgjimin e telekomunikimit, u jep të drejtë

institucioneve përkatëse të bëjnë punën e tyre dhe në këtë rast falënderoj edhe Qeverinë për bashkëpunim në këtë ligj. Thënë në tërësi, Grupi Parlamentar “6+” do ta votojë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lista serbe, Sasha Milosavleviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

I mi kao Poslanička grupa razmatrali ovaj nacrt zakona. Naš doprinos ćemo dati između dva čitanja, tojest ove nedelje koliko imamo rok za to i u načelu ćemo glasati za ovaj nacrt zakona. Hvala!

KRYETARI: Atëherë kanë përfunduar paraqitjet e grupeve parlamentare, tani e kemi radhën e diskutuesve nga deputetët. Zoti Elmi Reçica e ka kërkuar fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Përsëendetje zoti kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Projektligji për përgjimet e telekomunikimeve përveç rëndësisë që ka si projektligj ka edhe përmbushjen e kriterëve për liberalizimin e vizave. Po ashtu, është një projektligj i një rëndësie të veçantë për sigurinë kombëtare të republikës sonë. Kemi qenë dëshmitarë të debateve të ashpra që përgjimet kanë shkaktuar në shtetet me demokraci të konsoliduar dhe së fundi edhe në rajonin tonë. Duke qenë pra dëshmitarë të këtyre situatave e kemi të qartë se çështja e përgjimit nuk duhet të shihet vetëm nga prizmi i sigurisë, por është një çështje që prek të drejtat e njeriut, si dhe parimet demokratike të funksionimit të shtetit.

Prandaj, më vjen mirë që e kemi përpara nesh një projektligj, i cili në mënyrën më të mirë e ka rregulluar një fushë tejet komplekse për rrethanat dhe situatën tonë.

Projektligji është hartuar duke marrë parasysh edhe praktikën më të mirë në Bashkimin Evropian, si dhe Rezolutën e Këshillit të Bashkimit Evropian mbi përgjimin ligjor të telekomunikimeve. Në përmbajtjen aktuale gëzon përkrahjen e organeve të sigurisë dhe shoqërisë civile dhe kjo është një arritje e rëndësishme për procesin demokratik të këtij projektligji. Është e qartë që projektligji ka adresuar shqetësimet në lidhje me mbrojtjen dhe garantimin e privatësisë, për qytetarët e Kosovës dhe mundësit e keqpërdorimit të përgjimit, përmes krijimit të një sistemi me shtresa të mjaftueshme të kontrollit dhe llogaridhënies.

Projektligji parasheh themelimin e komisionarit për mbikëqyrjen e përgjimeve i cili do të mbikëqyrë respektimin e parimeve të ligjit në procedurën e përgjimeve. Krahas kësaj një rregullim tepër i rëndësishëm që bën ligji është ndarja e njësive ndërlidhëse dhe qendrës së monitorimeve, sepse kjo do të sigurojë se kemi një kontroll të fuqishëm dhe një procedurë e cila e vlerëson shumë hapësirën për keqpërdorime eventuale.

Për fund, dua të përgëzoj edhe ministrin Çollaku dhe tërë stafin e tij që vërtetë me punën e shkëlqyer që e kanë bërë në këtë drejtim kanë arritur ta sjellin këtë projektligj, besoj që do të jetë një projektligj që do t'i plotësojë ato çka është zbrazëtur aktuale dhe sidomos do të jetë i mirëpritur për integritet evropian. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Është i rëndësishëm ky projektligj për nevojat e Kosovës, por një nga ato që dua të theksohet pajtohem me parafolësit që është i një rëndësie të veçantë ky ligj, mua më intereson nga ministri që ndoshta ka mundësi të na japë një përgjigje te neni 5 lloji i përgjimeve.

Është paragrafi 1.2. thotë: “përgjimet për nevojat e strukturave të inteligjencës dhe sigurisë kombëtare”, këtu i kemi dy institucione të cilat merren në përgjim, unë mendoj që duhet të jetë për përgjimi për nevojat e sigurisë kombëtare e jo për strukturat e inteligjencës, sepse strukturat e inteligjencës janë mundësia e keqpërdorimit më të madh që mund të ndodh dhe kanë ndodh, dhe ndodhin nëpër vendet tjera.

Prandaj, rastet e Maqedonisë, përgjimet në Maqedoni i kemi pikërisht nga strukturat e inteligjencës dhe për këtë për siguri kombëtare jemi por jo për strukturat e inteligjencës me pas nevoja. Nëse më lejohet kjo atëherë nuk ka siguri dhe është keqpërdorimi më i madh që mund të lejohet të bëhet për shembull për përgjimet dhe çështja te gazetarët është çështje e burimeve. Me thashetheme nuk ka burime të gazetarëve, më tha ky portal e mora prej këtij portali, vjedhje nëpër portale, keqpërdorime nëpër portale ose facebook-ëve të ndryshëm pastaj është një keqpërdorim shumë i madh që është kah bëhet.

Dhe mbrojtja e këtyre burimeve te neni 7, kufizimet në përgjim duhet të ketë parasysh pikërisht kjo. Unë kërkoj që neni 5 të ndryshohet, të amendamentohet dhe të jetë për sigurinë kombëtare, dhe jo për nevojat e inteligjencës ose strukturat inteligjente. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Nait! Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

E kemi trajtuar këtë projektligj dhe i japim mbështetje që në fillim me miratimin e këtij projektligji, shihet që edhe ministri ka punuar, ministria në fakt ka punuar në këtë projektligj dhe janë bërë ndryshime substanciale sa i përket edhe qendrës së monitorimit dhe vërejtjeve të cilat kanë qenë nga deputetët edhe në shqyrtimi e këtij projektligji në mandatin e kaluar, por edhe në këtë mandat pasi që mandatin e kaluar kemi bërë një vizitë bashkë me komisionin parlamentar për mbikëqyrje të AKI-së në Slloveni.

Sllovenia këtë fushë e ka të rregulluar mjaft mirë, ne si komision parlamentar atëherë kur kemi vizituar e kemi parë që edhe sa i përket ruajtjes së fshehtësisë, por edhe Qendrës së Monitorimit, edhe qendrës monitoruese nga ana e policisë, por edhe strukturave të inteligjencës, sllovenët e kanë edhe qendrën monitoruese edhe në sferën ushtarake, por edhe njoftimin e qytetarëve kur ata kanë qenë të përgjuar, kur kanë qenë proceset e përgjimit nëse ato kanë rezultuar që ata qytetarë nuk kanë pasur arsye ose nuk kanë qenë pjesë e ndjekjeve penale, ose nuk kanë bërë ... penale atëherë edhe njoftimi i qytetarëve për kohën sa kanë qenë të përgjuar dhe për arsyen e përgjimit që në këtë projektligj nuk parashihet, unë mendoj që do të duhet të parashihet edhe kjo që

qytetarët njoftohen pas përfundimit, pas një periudhe të caktuar kohore varësisht se sa rregullohet me ligj, njoftohen për kohën sa kanë qenë të përgjuar.

Është në interesin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe mendoj që kjo duhet të rregullohet në këtë ligj, edhe për të heq at tabu në Kosovë që të gjithë përgjohen dhe të gjithë janë të përgjuar, mendoj do të ishte në sferën edhe në interesin e mbrojtjeve dhe të lirive të njeriut që kjo të rregullohet.

T'i kthehem konkret projektligjit një nga vërejtjet e mia është të llojit të përgjimit, mu ajo që e tha edhe deputeti Hasani, po mendoj që ndoshta në përkthim të këtij ligji është bërë ndonjë gabim, ndonjë shkelje për arsye se te neni 5, pika 1.2. ku thuhet përgjimet për nevojat e strukturave të inteligjencës dhe sigurisë kombëtare, sigurisht që është menduar përgjimet nga strukturat e inteligjencës për nevojat e sigurisë kombëtare, domethënë sigurisht që është menduar kjo dhe te neni 11 pika 2, tek urdhri për përgjim.

Urdhri për përgjim thuhet urdhri për masat e përgjimit nuk mund të lëshojë për një periudhë më të gjatë se 60 ditë nga data e lëshimit të urdhrit dhe mund të vazhdohet vetëm sipas kriterëve. Sigurisht, këtu po mungon një “jo”, domethënë jo më të gjatë se 60 ditë dhe të masave parimet e fshehtësisë dhe masave ndëshkimore. Mendoj që me këtë ligj rregullohen parimet e ruajtjes së fshehtësisë, parashihen masat ndëshkimore për operatorët e telekomunikimeve, masat ndëshkimore janë paraparë, por nuk parashihen masa ndëshkimore për individë të cilët mundën me e keqpërdorë pozitën e tyre në këto institucione, qoftë ata në sektorin e sigurisë, policisë apo të inteligjencës apo edhe ata të cilët punojnë në kuadër të operatorëve të telekomunikimeve.

Janë paraparë masa ndëshkimore për operatorët që kapin shifra monetare, por jo edhe përgjegjësi penale. Mendoj që edhe përgjegjësia penale duhet të futet këtu për udhëheqjen e operatorëve të telekomunikimeve, por edhe për individët të cilët mund të abuzojnë me të dhëna të cilët i posedojnë nga kjo. Kjo është në sferën e ruajtjes së privatësisë dhe interesit dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarit. Faleminderit, ministër uroj që edhe gjatë amendamentimit të bashkëpunojmë dhe të krijohet një ligj tamam në sferën e interesit për të cilën është projektuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, nuk ka më të paraqitur për diskutim. Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për përgjimin e telekomunikimeve.

Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar gjithsej 63 deputetë, 60 kanë votuar për, 3 kanë abstenuar, nuk kemi votë kundër.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për përgjimin e telekomunikimeve, kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime për seancën plenare e cila do të mbahet, më 28 maj 2015.

Fillojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat

Në bazë të nenit 56, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

E ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar deputetë, anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që para jush të prezantoj për ndryshim dhe plotësim Ligjin 031/199 për Gjykatat, më lejoni që në fillim të them që ky ligj është në pjesën e atyre ligjeve që ka të bëjë edhe me plotësimin e kriterëve për liberalizimin e vizave, por njëkohësisht për rritjen e funksionalitetit në gjykatat tona, përfshirë edhe pavarësinë më të madhe për këto llogaridhënie.

Më lejoni t'i theksoj pikat kryesore që parashihen për ndryshim në këtë projektligj: çështja e parë është që kushtet për emërimin e kandidatëve për gjyqtarë si kushtet e përgjithshme, ashtu edhe të veçanta në pajtim me kushtet që janë paraparë edhe në vendet e tjera të rajonit, por edhe ato të BE-së janë harmonizuar në tërësi. Në këtë drejtim është bërë harmonizimi i pikave që kanë të bëjnë me përzgjedhjen e prokurorëve dhe fleksibilitetin e zgjedhjes së gjyqtarëve me qëllim që të nxiten kuadrot e reja të jenë pjesë e këtij sistemi.

Po ashtu, çështje e veçantë ka qenë harmonizimi dhe fleksibiliteti i kriterëve për avancimin e gjyqtarëve në kuadër të sistemit të gjykatave. Ky avancim siç edhe mund të shihet në këtë projektligj ka të bëjë kryesisht me performansën që mund ta tregojnë ata gjatë punës së tyre. Një çështje e veçantë ka të bëjë themelimi i Departamentit të veçantë për çështje ekonomike në kuadër të Gjykatës themelore në Prishtinë që do të funksionojë një divizion i veçantë për kontestet që lidhen me investitorët e huaj, me juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Në këtë projektligj me qëllim të ofrimit më të mirë të shërbimeve për qytetarët e vendit tonë, në disa komuna të vendit tonë po ashtu me lehtësimin e barrës së gjykatave janë paraparë edhe tri degë të themelohen. Kjo ka të bëjë, me degën e gjykatës themelore në Fushë Kosovë, po ashtu me degën e gjykatës themelore në Komunën e Obiliqit, dhe me degën e gjykatës themelore në komunën e Junikut.

Një ndër çështjet me rëndësi është edhe publikimi i vendimeve, vendimeve të formës së prerë të gjykatave me qëllim të rritjes së transparencës së këtyre gjykatave. Më lejoni të them që këtu janë paraparë edhe dispozita të veçanta që kanë të bëjnë me bashkëpunëtorët profesional, me praktikantët, interpretët dhe përkthyesit e gjykatave, të cilët gjithmonë do të parashihen dhe rregullohen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe do të përzgjidhet po ashtu nga ky këshill.

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni të them edhe një herë, dispozitë që i mungon këtij projektligji dhe që e kam propozuar që nga viti 2011, kam propozuar prapë dhe me kërkesën po them implicite të faktorëve ndërkombëtarë është hequr, kjo ka të bëjë me Dhomën e Veçantë, në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës, që nënkupton se aktakuzat e ngritura nga prokuroria speciale e Republikës së Kosovës të shqyrtohen në këtë Dhomë.

Po ashtu, më lejoni të them se me këtë do të rritet profesionalizmi i gjykatave, gjyqtarët do të ishin profesionistë, do të kishin trajtim të njëjtë edhe profesional, por edhe material, por mbi të gjitha do të rritej efikasiteti i kryerjes së këtyre punëve.

Unë jam i gatshëm që të jap kontributin tim në Komisionin për Legjislacion për plotësimin e kësaj dispozite. Dhe krejt në fund më lejoni të them që këto ligje janë harmonizuar në plotësi dhe kemi diskutuar me përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor, Prokurorial me të EULEX-it dhe BE-së, por po ashtu jam i gatshëm që të marr pjesë në komision për përmirësimet eventuale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Të nderuar deputetë, pas prezantimit të Projektligjit hapi debatin për diskutim në parim. E ftoj Albulena Haxhiun, kryetare e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, ta marrë fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Atëherë, fillimisht më duhet të them që para se ta prezantoj ministri i Drejtësisë Projektligjin për Gjykata është dashur që ta informojë edhe Kuvendin, edhe qytetarët e Republikës se pse nuk i ka sjellë këto projektligje në afatin 31 marsin, pra që e përmendi më përpara edhe shefi i Grupit Parlamentar, Glauk Konjufca.

Pra, edhe Projektligji për gjykatat edhe ai për këshillin gjyqësor, edhe Projektligji për prokurorinë e shtetit dhe këshillin prokuroria është dashur që të sjellin në Kuvend më 31 mars të vitit 2015, dhe tani jemi në maj dy muaj pas dhe ministri i Drejtësisë i ka sjellë javën e kaluar këto projektligje dhe po kërkohet që të votohen me procedurë të përshpejtuar.

Pra, është tepër e rëndësishme që të na informoni se pse ka ndodhur kjo, sepse po duket që është e qëllimshme që të na pamundësohet më pas neve si komision, mirëpo edhe si deputetë të Kuvendit që të bëjmë ndryshimet përmbajtjesore në këtë projektligj. Pra, po pres një përgjigje nga ministri në lidhje me këtë dhe meqë po flas në emër të komisionit po e lexoj rekomandimin e komisionit.

Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2015, e shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L 199 për gjykata dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqes këtë rekomandim, pra që të miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat.

Ndonëse vërejtjet në këtë ose ndryshimet në këtë projektligj janë të karakterit funksional ne si Komision për Legjislacion përbrenda kohës dhe mundësive që kemi në bashkëpunim edhe me institucionet e drejtësisë, respektivisht Këshillin Gjyqësor dhe përfaqësuesit e gjykatave dhe

shoqërinë civile pse grupet tjera të interesit do të mundohemi që t'i adresojmë ose që t'i përpilojmë amendamentet që janë në përputhje me kërkesat e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani Selviqe Halimi, nga Partia Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuari ministër,

Plotësim ndryshimi i Ligjit të nr. 03/L-199 për gjykatat që na është ofruar neve si deputetë, është një projektligj i cili do të ndikojë në ngritjen e profesionalizmit të punës në gjykata, për çka edhe ju falënderojmë si grup parlamentar, dhe njëherësh Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështetë në parim këtë projektligj dhe ndjej për obligim moral të ju njoftoj se edhe në Komisionin Funkcional, por edhe gjatë punës, gjatë amendamentimit grupi parlamentar do ta japë kontributin e vet duke kërkuar gjithashtu nga ministri që të bashkëpunojë ngushtë lidhur me amendamentimin e nevojshëm që mund të ndodh deri në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, fjalën e ka Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Sundimi efektiv i ligjit në Republikën e Kosovës mbetet një ndër çështjet themelore për një zhvillim qoftë ai politik, ekonomik, social dhe atë të sigurisë edhe pse ky reformim mbetet sfidë për institucionet tona, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës do të përkushtohet që të kontribuojë në eliminimin e mangësive të paraqitura, si dhe në avancimin e ligjit si e mirë për forcimin e sistemit të drejtësisë qoftë ndaj asaj që quhet lufta kundër krimit dhe korrupsionit, por edhe sistemit gjyqësor në vend.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin në fjalë dhe unë do t'i paraqes 2-3 vërejtje, të cilat janë parimore edhe përmbajtjesore edhe të cilat mendojmë që në mes të dy leximeve të kontribuojmë në avancimin e Ligjit për gjykatat.

Te neni 3, sa i përket ndarjes së degëve të reja në formimin e degëve ku është dega në Fushë Kosovë, Komunën e Obiliqit, po ashtu dega në Komunën e Junikut për neve është e pranueshme, mendojmë që në kuadër të gjykatës themelore të Ferizajt nëse është e mundur për shkak të hapësirës territoriale të jetë edhe dega për komunën e Shtimjes.

Sa i përket kushteve dhe përzgjedhjes së gjyqtarëve ka të bëjë me trajnimin fillestar të gjyqtarëve të cilët pas emërimit, mendoj që kjo çështje duhet të rivlerësohet nëse një gjyqtar emërohet domethënë që ai është i gatshëm që të ushtrojë mandatin e tij, ndërsa trajnimi fillestar domethënë edhe përpos kualifikimeve tjera është parë edhe në praktikë është marrë më shumë me harxhim të kohës se sa ndonjë avancim adekuat të gjyqtarëve për ta ushtruar funksionin e gjyqtarit.

Te pika 4.3, për ta ushtruar funksionin e gjyqtarit të gjykatës së apelit, gjyqtari duhet të ketë së paku 5 vjet përvojë si gjyqtarë. Neve mendojmë që kjo përvojë duhet të rritet në 7 vjet, qoftë për gjyqtarë apo edhe si prokurorë duke marrë parasysh funksionin që ushtron gjykata e apelit e

njëjta të rritet po ashtu edhe për Gjykatën Supreme nga 8 vjet në 10 vjet, për shkak të rëndësisë edhe të specifikave që shqyrtojnë lëndët në shqyrtim.

Te veprimtaritë profesionale dhe çështja më delikate e cila është diskutuar gjatë, qoftë në stërngarkimin me lëndë të caktuara dhe qoftë në punën efektive të Gjyqësorit është punësimi në shumë vende pune për gjyqtarët e të gjitha niveleve.

Grupi Parlamentar i LDK-së kohë pas kohe e ka ngrehur këtë çështje jo vetëm për gjyqësorin, por edhe për organizata dhe funksione të tjera dhe ne mendojmë që për gjyqësorin duhet të sigurohen apo të gëzojnë fonde të mjaftueshme për t'i kryer funksionet e veta në mënyrën e duhur. Pagat e gjyqtarëve të vendosen në shtyllat e ndarjes së barabartë të pushtetit, mes gjyqësorit-ekzekutivit dhe legjislativit që kjo nënkupton edhe te neni 10, kështu që neni 2 që thotë që gjyqtarët mund të angazhohen në veprimtaritë që janë në përputhje me Kodin Etik dhe sjelljen profesionale të gjyqtarëve, siç është pjesëmarrja në takime shkencore, ligjërata apo trajnime dhe pjesëmarrje në përgatitjen e projekteve të ndryshme ligjore, gjyqtarët mund të marrin kompensim për veprimtaritë e tilla në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kjo çështje ka krijuar mospërputhshmëri ta quaj ndërmjet funksionit të gjyqtarit, por edhe dilema se sa janë efektiv në punën dhe mandatin që ushtrojnë. Ne e kishim së fundi edhe Raportin e institutit gjyqësor kur nga 145 ditë pune 72 gjyqtarë kanë mbajtur trajnime, domethënë jo vetëm të përkohshme por permanente dhe kjo tregon që mund të mungojnë apo nuk mund ta kryejnë detyrën e vet siç duhet.

Andaj, duke u siguruar kushte dhe duke u siguruar fonde të mjaftueshme, mendojmë që kjo çështje dhe ky amendament duhet të hiqet dhe gjyqtarët në të gjitha nivelet ta kenë vetëm pozitën e gjyqtarit dhe kjo t'i ndihmojë me të vërtetë sistemit të drejtësisë në vend. Grupi Parlamentar i LDK-së shpreh gatishmërinë që qoftë në afatin e shkurtë në mes të këtyre dy leximeve të jap kontributin e vetë në bashkëpunim edhe me sponsorizuesin dhe me grupet tjera parlamentare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lista serbe lutem se s'po lajmërohen, pastaj unë po i kaloj, që të jem korrekt. Atëherë Donika Kadaj-Bujupi, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Albulenë, më fal, kërkoj falje, ishte gabimi im, ke të drejtë plotësisht. Urdhëro! Kërkoj falje!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Edhe pse kemi si Grup Parlamentar shumë vërejtje në këtë projektligj, unë po i përmendi disa që i konsiderojmë që janë të rëndësishme dhe përmbajtjesore.

Aktualisht kandidatët për gjyqtarë është dashur që ta kryejnë një trajnim fillestar të obligueshëm dhe pas këtij trajnimi të hyjë në një provim të veçantë dhe më pas të emërohen si gjyqtarë. Gjithë këtë procedurë, pra e realizon Instituti Gjyqësor i Kosovës.

Tani me ndryshimet e propozuara thuhet se njëherë emërohen si gjyqtarë dhe më pas trajnohen, pra në afat prej 12 muajve. Nuk ka një arsyetim konkret se pse tani po kërkohet kështu, dhe për bindjen tonë nuk është veprim i duhur ose propozim i drejtë meqë nuk kemi një arsyetim, sepse sikur ta kishim arsyetimin ndoshta edhe do ta konsideronim, mirëpo nuk na ka ardhur një

arsyetim se pse po kërkohet që të bëhet ky ndryshim që për mendimin tonë është tepër i rëndësishëm.

Mendoj se shumë më mirë do të funksiononte që fillimisht të trajnohen dhe më pas të emërohen si gjyqtarë të gjykatave. Sepse, po shndërrohen Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës si institucione arsimore, të cilat organizojnë provime për gjyqtarë dhe për prokurorë.

Ne e kemi Institutin Gjyqësor të Kosovës dhe për bindjen tonë deri më tani për atë që ka pas mundësi Instituti Gjyqësor i Kosovës e ka bërë punën ose e ka bërë ngritjen profesionale të gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

Në nenin 8, paragrafi 4 thuhet se gjyqtarët e emëruar do të vlerësohen pas përfundimit të trajnimit fillestar në përputhje me dispozitat relevante të këtij ligji dhe nëse mbetet kështu, pra që trajnimi të bëhet pas emërimit si gjyqtarë duhet të qartësohet se nga kush duhet të vlerësohen ata gjyqtarë dhe mendoj se do të duhet të shkruhej që është komisioni vlerësues ose për vlerësimin e performansës.

Në nenin 26 të kushtet për emërimin e gjyqtarëve, paragrafi 1.4 thuhet që të ketë të kryer provimin e jurisprudencës dhe për të eliminuar çfarëdo paqartësie ose për të mos lejuar interpretime të tjera duhet të precizohet që provimi i jurisprudencës të Kosovës, pra të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu në nenin 16, pika 1.5 thuhet të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet moral. Unë kam një pyetje se ku e merr ai kandidat për gjyqtarë certifikatën për reputacion të lartë ose profesional ose integritet moral. Pra, ndonëse kjo ekziston nëpër secilin kusht për gjyqtarë, prokurorë, mirëpo edhe çfarëdo pozicioni tjetër asnjëherë nuk specifikohet se ku ose kush e mat reputacionin profesional ose moral.

Gjithashtu, një çështje që është tepër e rëndësishme ka të bëjë me veprimtaritë profesionale. Në rrethanat tona ka pasur shumë kritika se gjyqtarët dhe prokurorët kanë pasur më shumë se 3, 4 e 5 vende tjera të punës, përkatësisht ligjërime nëpër universitete qoftë publike apo edhe private. Madje, ka pasur edhe zëra edhe nga vetë Agjencia Kundër Korrupsionit që ka thënë që nëse një gjyqtarë është ligjërues në ndonjë fakultet privat, atëherë ai nuk është aty se është profesionist por pse është gjyqtarë dhe dihet se pse është aty.

Në këtë projektligj nuk kufizohet ligjërimi, unë mendoj që është koha kur gjyqtarët fare nuk do të duhej të ishin edhe ligjërues, pra që të ligjërojnë në universitete qoftë publike apo edhe private. Mirëpo të fokusohen në punët e tyre që i kanë, aktualisht i kemi 450 mijë lëndë të pluhurosura në sirtarët e gjykatave dhe si ka mundësi që një gjyqtarë të jetë efikas nëse i ka 2, 3 e 4 vende tjera të punës ose ligjëron në 4 e 5 vende tjera të punës madje edhe brenda orarit zyrtarë, sepse i dimë edhe makinat e tyre zyrtare që parkohen përballë universiteteve private.

Pra, mendoj që kjo duhet të adresohet dhe mos të lihen që të jenë edhe ligjërues, mirëpo nëse ka tepër kritika siç e di që mund të ketë, atëherë me leje të këshillit gjyqësor të paktën 2 ose 3 orë në javë dhe jo më shumë.

Pra, këto janë disa nga vërejtjet e lëvizjes “Vetëvendosje” dhe gjatë kësaj jave do të mundohemi që t’i shndërrojmë edhe në amendamente. Në parim, ne e përkrahim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të Qeverisë,

Realisht konsiderojmë që mosfunksionimi i Gjyqësorit është një ndër sfidat me të cilat është ballafaquar Kosova në këto 15 vjetët e fundit, madje sundimi i ligjit është një ndër kriteret e papërmbushura për liberalizim të vizave edhe pse shpesh kemi pas premtime edhe nga ish-kryeministri dhe ky i tanishmi që madje kanë dhënë edhe data, për liberalizim të cilat asnjëherë nuk janë përputhur me realitetin dhe zbatimin në përmbushjen e kritereve nga ana e vendit tonë.

Po e jap dhe po e përsëris edhe unë një specifikë, ky ligj dhe kjo pako e projektligjeve është dashur të silltet në Kuvend më datën 31 mars në mënyrë që deputetët të kenë mundësinë që të punojnë më substancialisht në to dhe të japin kontributin e tyre. Përderisa gjithçka që po vjen nga Qeveria po vjen me shpejtësi drite dhe shumë shpesh shkel e shko vetëm sa për të plotësuar një afat kohor të paraparë, ne do ta përkrahim në parim shumë të pakënaqur në përgjithësi me ngecjet që po vijnë nga resori përkatës dhe me këtë neglizhencë që po i bëhet projektligjeve të cilat janë tepër të rëndësishme për funksionimin e gjyqësorit dhe kërkojnë një trajtim shumë më afatgjatë dhe më profesionistë në mënyrë që të mos kemi nevojë që prapë pas dy vjetëve kur përsëri të kemi ngecje në liberalizim sepse definitivisht me këto dinamika liberalizimi për fat të keq nuk pritet të ndodhë as sivjet, por ndoshta as vitin tjetër.

Të na kërkohet përsëri me një shpejtësi të njëjtë që të bëjmë një plotësim ndryshim të ligjeve të njëjta të cilat edhe në të kaluarën ka ndodh që të kërkohen plotësim ndryshime kohë pas kohe ende pa u zbatuar ato të cilat kanë kaluar në Kuvend.

Prandaj, mendoj që një qasje më serioze në kuptimin edhe të përmirësimit dhe plotësim ndryshimit të ligjeve të caktuara, por me theks të veçantë të zbatimit të ligjeve që veçse janë në fuqi do të duhej që të paktën në këtë kohë kur po flasim për liberalizim të jetësohet dhe të funksionalizohet sundimi i ligjit në vendin tonë, ndryshe me këto improvizime për një kohë shumë të gjatë nuk do të ecim përpara dhe veçse do të vazhdojmë me at temin e kapjes së shtetit dhe mungesës së sundimit të ligjit në përgjithësi.

KRYETARI: Faleminderit! Shukrije Bytyqi, nga “Nisma”, e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtetë jemi dëshmitarë se kemi shumë ngecje në drejtësi dhe në sundimin e ligjit, Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” e ka shqyrtuar Projektligjin për gjykatat dhe e mbështet në parim me vërejtjet që i bënë edhe kolegët parafolës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Danush Ademi, nga “6+”, e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryetar!

Grupi “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshime dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat, ku në nenin 3, neni 10 të ligjit paragrafi 2, pas nën paragrafi 2.4 ku shtohet nënparagrafet 2.5 dega në Fushë-Kosovë për komunën e Fushë-Kosovës dhe komunën e Obiliqit, dega në Junik në komunën e Junikut të shtohet në degën e Ferizajt dhe në komunën e Shtimes.

Kjo është kërkesë e Grupit Parlamentar “6+”, kurse në parim do ta përkrahim këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë nga grupet parlamentare nuk kemi tjerë të paraqitur edhe njëherë Lista Serbe nuk po lajmërohet. Nuk ka. Atëherë unë e kaloj radhëve tjera në qoftë se nuk ka të lajmëruar në ekran. E kemi edhe radhën e diskutuesve nga deputetët, është lajmëruar vetëm Margarita Kadriu-Ukelli. Urdhëroni deputetë!

MARGARITA KADRIU-UKELLI: Përshëndetje, i nderuar kryetar!

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sistemi gjyqësor dhe prokuroria vazhdon të mos u garantojë qytetarëve të këtij vendi edhe atë që e garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës, barazinë e qytetarëve para ligjit.

Në fakt, në republikën tonë një pakicë vazhdon të jetë mbi ligjin dhe shumica të jetë e nëpërkëmbur. Pushteti u tregon muskujt kryesisht të pafuqishmëve, njerëzve pa mbështetje politike, pa para. Individët me pushtet, me lidhje të forta arrijnë të dalin pa u lagur edhe në skandalet e rënda korruptive.

Modeli kosovar i sundimit të ligjit është një shembull i keq që ka pasoja të rënda në stabilitetin e shtetit, tremb investitorët e huaj dhe ua humb shpresën qytetarëve të vetë për një drejtësi të paanshme. Fatkeqësisht, gjatë këtyre 16 vjetëve të pasluftës gjykatat dhe prokuroritë jo vetëm që nuk u bënë të pavarura dhe të paanshme dhe nuk u konsoliduan, por rrëshqitën dhe mbetën në brazën e hullinë e politikanëve të korruptuar.

Qindra mijëra lëndë janë mykur në sirtarët e gjykatave dhe prokurorive, KGJK-ja dhe KPK-ja po tregohen të pafuqishme dhe jokompetente për reforma serioze e të thella, rrënjësore, ligjore e kuadrore, duke marrë për bazë gjendjen tepër të degraduar në drejtësinë kosovare. Sot ne, deputetët e Kuvendit të Kosovës kemi para veten katër projektligje shumë të rëndësishme, në të cilat duhet bërë ndryshime e plotësime tepër të nevojshme.

Një ndër çështjet më të rëndësishme që duhet të jetë në këto projektligjet të plotësuara është saktësimi me ligj i përgjegjësisë dhe llogaridhënies e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial dhe organizimi i tyre si organe më të larta në pushtetin e tretë vendit.

Tani ne kemi një krye prokuror të ri nga i cili pritet të fillojmë llogaridhënien e anëtarëve të KPK-së, por edhe të vetë prokurorëve lidhur me performancën e tyre. Duhet të fillohet me

pastrimin e prokurorisë së shtetit nga prokurorët e korruptuar, të pamerituar, të lidhur me politikën dhe oligarkët e tyre, të kontrolluar nga ta gjë që e cila bie ndesh me etikën, sjelljen dhe integritetin e të qenurit prokuror i shtetit.

Kjo që u tha për prokurorinë e shtetit vlen e tëra edhe për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Nëse duam të fillojmë të zgjedhim problemet në drejtësi ne duhet të saktësojmë me ligj saktësisht se kush mund të bëhet dhe kush mund të mbetet gjyqtarë dhe prokuror. Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët aktual të lidhur, të sjellur apo të ndikuar nga politika dhe oligarkët e tyre duhet të largohen nga gjyqësori dhe prokuroria për mungesë të etikës, të sjelljes dhe të integritetit profesional.

Deri më sot llogaridhënia nuk ka ekzistuar fare, andaj këto gjëra duhet të përcaktohen qartë me ligj nga Kuvendi e jo të lihen me rregullore të ngjashme apo dokumente të ngjashme nga KGJK-ja dhe KPK-ja. Në mesin e shumë çështjeve që duhet shtuar në këto plotësim projektligje është edhe rregullimi i angazhimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në punët e tjera sekondare. Në Kosovë, zyrtarët qeveritarë, të nxitur nga orekset në stilin e “supermenëve” e kanë sjellë një modë për mbajtjen e shumë pozitave.

Një fenomen i tillë është i pranishëm edhe te gjyqtarët dhe prokurorët gjë që është edhe shkelje e kodës së etikës, integritetit dhe sjelljes i cili nuk lejon që shuma e kompensimit të tejkalojë 25% nga paga e rregullt mujore. Një tjetër çështje është edhe përbërja e KGJK-së dhe KPK-së që do të trajtohet në dy ligjet pasuese ende nuk është saktësuar çështja e anëtarit të këshillit që vjen nga Oda e Avokatëve pasi duke ushtruar detyrën e avokatit, ndërsa merr pjesë në procese emërimesh dhe riemërimesh, përbën konflikt interesi. Kjo çështje duhet të rregullohet me ligj dhe jo me rregullore, ngase hipokrizitë mund të ndodhin sikur kanë ndodhur çdo ditë deri më tani.

Andaj, para nesh është një detyrë tepër e rëndësishme dhe këtë duhet ta bëjë me kujdes dhe me maturi, pa nguti, sepse përfundimisht duhet të kthehet besimi i qytetarëve në drejtësi e gjë që është shumë vështirë të bëhet brenda katër ditëve, për të cilët ju edhe votuat.

Të gjitha këto duhet t’i diskutojmë edhe me një rreth më të gjerë të shoqërisë civile, në mënyrë që të bëjmë ligje ku përfitues do të jenë qytetarët e këtij vendi e jo grupet e caktuara të interesit qofshin edhe ato nga sektori i drejtësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka të lajmëruar deputetë tjerë për diskutim. Atëherë fjalën e ka ministri i Drejtësisë, zoti Hajredin Kuçi.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Faleminderit të nderuar deputetë,

Edhe për diskutime, sugjerime dhe vërejtjet, unë jam i bindur që ligji nuk është i përkryer dhe natyrisht që vërejtjet tuaja janë substanciale.

Por, po ashtu më lejoni të them që unë kam pas një tendencë të balancimit të kërkesave që kanë ardhur nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial dhe të tjerët, dhe e kam prurë një ligj që nuk përfaqëson vetëm mendimin tim por përfaqëson edhe atë balancën e duhur. Disa diskutime që u thanë sot përputhen me mendimet e mia në tërësi, nga deputetja e nderuar zonja Haxhiu. Unë

pajtohem plotësisht që nuk janë sjellë me kohë këto ligje, por dua ta them po ashtu ligjet kanë qenë të përgatitura në prillin e vitit të kaluar. Kriza politike në vend s'e ka lejuar një gjë të tillë dhe në janarin e këtij viti kam pasur kërkesë decidive nga përfaqësuesi i OSBE-së në Kosovë, që të mos procedohen deri në këtë kohë, po e them publikisht. Pra, nuk ka qenë mungesë e përgatitjes së këtyre amendamenteve.

U përmend çështje e përgatitjes apo trajnimit edhe nga zoti Zemaj dhe zonja Haxhiu, e trajnimit të gjyqtarëve. Edhe unë kam dilemat e mia, por propozimi ka ardhur nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial. Ata i kanë disa arsyetime të tyre dhe arsyetimet janë ndër të tjera, që njerëzit duhet të dihet kush janë gjyqtarë dhe prokurorë dhe të mos investohet në trajnime, sikurse e kanë edhe një qëllim të veçantë, që ata të jenë ndikues në procesin e trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për të mos thënë edhe në përzgjedhjen e tyre paraprake.

Më lejoni të theksoj, po ashtu, angazhimin në shumë vende të punës. Unë pajtohem plotësisht, që të hiqet kjo dispozitë. Dhe, po e them, nuk kam asnjë dilemë. Ne kemi tentuar ta bëjmë një balancim me një leje nga Këshilli Gjyqësor, respektivisht Këshilli Prokurorial i Kosovës, me një shumë deri në 25%, por ka reagime nga Këshilli Gjyqësor, respektivisht Këshilli Prokurorial.

Unë jam i bindur, në debatet publike ku do të marrin pjesë edhe ata do t'i mbrojnë ose do t'i refuzojnë qëndrimet e tilla. Por, unë mendoj, se duhet të vlejë e njëjta gjë edhe për ne. Po e them, kur bëjmë për Këshillin Gjyqësor, për gjyqtarë dhe prokurorë, duhet ta bëjmë ligjin që vlen edhe për ministra, përfshirë edhe mua, dhe për deputetë e të tjerë, jo vetëm për një pjesë të sistemit.

Po ashtu, më lejoni të them, që zoti Zemaj e përmendi degën në Shtime. Pajtohem plotësisht, por komuna e Fushë Kosovës, e Junikut dhe Obiliqit kanë bërë kërkesë dhe, unë nga sot po pajtohem që të jetë edhe dega në Shtime dhe besoj se do ta kem pëlqimin edhe të Komisionit.

U përmend çështja e avancimit. Zoti Zemaj, ne kemi qenë të kujdesshëm t'u japim mundësi prokurorëve dhe gjyqtarëve të rinj. Pesë vjet janë të mjaftueshme që të avancohen, përndryshe kemi pasur një strukturë, që na kanë mbetur vetëm strukturë më e vjetër, s'kemi mundur të avancojmë njerëz. Dhe, sot nëse i marrim, kryetari i Gjykatës Supreme në Kosovë është njeriu më i ri në Gjykatën Supreme. Unë e kam një tendencë pak më ndryshe, mosha dyzetvjeçare duhet të jetë e përafërt për individin që të kalojë në Gjykatën Supreme, tridhjetë – tridhjetepesë në Gjykatën e Apelit, e kështu me radhë. T'i japim mundësi, ta freskojmë pak sistemin gjyqësor dhe prokurorial në vendin tonë.

Sa i përket pagave, është përmendur disa herë çështja e pagave. Në vitin 2011 ky Kuvend, 2010-ën ka miratuar ligjin, 2011 pastaj, kemi vënë një pasus, kemi thënë "...së paku në nivel të kryeministrit, së paku në nivel të ministrit..." e kështu me radhë, në nivel të tyre, tani kemi ndryshuar atë pasus, kemi thënë që "... paga është së paku", do të thotë mund të jetë më shumë. Dhe, hera e parë në këtë vend, që sistemi gjyqësor, respektivisht prokurorial po avancohet më shumë se dega e ekzekutivit.

Por, po ashtu duhet ta them, se kemi paraparë besoj me vëmendje, që administrata apo stafi administrativ të rregullohet me një ligj të veçantë. Çka i bie kjo? Të hyrat që bëhen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës të ndahen për disa qëllime, jo vetëm për paga.

U përmend nga zonja Haxhiu me të drejtë, mbi 400 mijë lëndë dhe, unë kam dhënë propozim dhe besoj se do ta kem mbështetjen tuaj, që të punohet ditëve të shtuna, ose mbi normë, për atë të paguhen gjyqtarët dhe të zvogëlohet numri i lëndëve. Nuk fitohet besimi në drejtësi, nëse një lëndë bën pesë vjet, besoj edhe më shumë, për t'u zgjidhur.

Dhe, unë besoj që në këtë drejtim, për çka duhet ta bëjmë një ndarje, të hyrat që vijnë nga qytetarët, nga taksat... 21 taksë vijnë vetëm për Këshillin Gjyqësor, asnjë për Këshillin Prokurorial. Duhet ta bëjmë një ndarje. Së paku dy taksa, që kanë të bëjnë me organet paraprake të gjykimeve, hetimeve e kështu me radhë, të ndahen edhe për Këshillin Prokurorial, pasi ne duhet ta trajtojmë njëjtë edhe administratën edhe gjyqtarët edhe prokurorët në mënyrë të njëjtë.

Më lejoni të them, që u përmend nga zonja Kadriu me të drejtë, çështja e përgjegjësisë të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial. E keni parë, në ligje kemi vënë tash mundësinë e shkarkimit. Deri në këto ligje s'ka pasur mundësi për shkarkim të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial. Por, po ashtu duhet ta them që Këshilli Gjyqësor shumicën e tyre i emëron Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ata sjellin raport për miratim në këtë Kuvend dhe, unë ju ftoj bashkë me mua, edhe ju gjithnjë, të bëjmë debat për atë raport. Miratimi ose mosmiratimi nënkupton edhe shkarkim.

Unë nuk kam kurrgjë, por çdo raport që e miratoni në këtë vend, për çdo institucion të pavarur, dijeni që është miratim edhe i mandatit të tyre, por ato që i rrëzoni, duhet të kërkon përgjegjësi. Nuk mjafton vetëm t'i rrëzohet raporti dikujt e t'i thuash "vazhdo me punën". Dhe, unë mendoj që Kuvendi duhet ta rrisë këtë çështjen e përgjegjësisë.

Sa u përket investitorëve të huaj, që u përmend me të drejtë nga zonja Kadriu, kemi paraparë një Departament të veçantë në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, që do të merret me trajtimin e investimeve të huaja në Kosovë, që do të ketë kompetencë për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Dhe, unë këtu besoj që është një kompetencë shtesë, por edhe një përqendrim yni në këtë drejtim.

U përmend llogaridhënia dhe po e them shumë hapur, të gjithë ne jemi të vetëdijshëm, në emër të pavarësisë së sistemeve i kanë ikur llogaridhënies, të gjithë. Shikoni, të gjithë. Kur them të gjithë, mendoj edhe në Këshillin Gjyqësor, edhe Prokurorial edhe të tjerët, por edhe agjencitë që janë të pavarura, që thonë janë të pavarura, është e vërtetë që janë të pavarura prej vendimmarrjes, por nuk janë të pavarura prej llogaridhënies.

Në këtë drejtim duhet ta rregullojmë këtë çështje, sikurse e kanë vendet tjera. Unë jam i bindur, që vendi ynë duhet ta marrë një model dhe nuk mund të jetë vend i eksperimenteve, se ne shpeshherë kemi veprime, që përgjegjësia politike bie me ose pa të drejtë, edhe mbi ekzekutivin, në momente të caktuara edhe mbi mua, por fuqia juridike është zero. Atij që ia jepni përgjegjësinë duhet dhënë edhe fuqinë, ose e kundërta, ai që e ka fuqinë juridike duhet ta marrë edhe përgjegjësinë.

Dhe, unë pajtohem plotësisht, që masat e disiplinimit edhe Zyra e kryeprokurorit disiplinor duhet të zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës, jo nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial, se ai ka për t'i hetuar ata njerëz vetë. Unë mendoj me 2/3-at e deputetëve të Kuvendit të Kosovës duhet të

zgjedhur kryeprokurori dhe ai, në një mënyrë ose tjetrën, është i pavarur, po ashtu themi me 2/3-at shkarkohet dhe ta bëjë disiplinimin e tyre. Momentalisht kemi një kryeprokuror, që mund të jetë i mirë, ose sido që mendojmë, por ai fuqinë e ka për aq sa shkon për t' i prekur anëtarët e Këshillit, në moment që fillon të bëjë një hetim, Këshilli ka për ta shkarkuar.

Nuk ka asnjë logjikë, që i njëjti individ që bën hetimin ndaj anëtarëve, njëkohësisht t' i themi që ai ka mundësi të shkarkojë edhe vetë atë Këshill. Dhe, në fund, zonja Kadriu e tha me të drejtë, Oda e Avokatëve të Kosovës nuk duhet ta ketë përfaqësuesin në Këshill Prokurorial.

Unë kam propozuar personalisht, që ministri të mos jetë dhe, konflikt interesi është edhe më shumë që të jetë Oda e Avokatëve të Kosovës, por, vendimet e tilla duhet t' i marrim bashkërisht edhe me një konsensus politik.

Unë jam i gatshëm të marr pjesë edhe për ndryshimet që i thatë, të vetmen lutje që e kam, është që llogaridhënien ta respektojmë në tërësi, natyrisht pavarësinë e tyre në tërësi dhe ato që janë kriteret të BE-së, që kërkohen nga ne për liberalizim të vizave, t' i respektojmë. Ndryshime të tjera, unë jam shumë fleksibil, që t' i bëjmë. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, fjalën e ka kërkuar zoti Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI: Ne kemi dëgjuar shumë herë deklarata, që kanë të bëjnë me mosfunksionimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë dhe, çështjet e fundit që kanë ndodhur në Këshillin Prokurorial dhe në Këshillin Gjyqësor, e kanë dëshmuar, që ne duhet ta ndryshojmë këtë situatë, duhet ta pamundësojmë luftën e brendshme publike dhe politike brenda gjyqësorit, brenda Prokurorisë dhe brenda Këshillit Gjyqësor. Por, ajo që është e evidente, për të cilën nuk flasim veç ne, ose në Parlament flasim më së paku, ku do të duhej të flitej shumë, është sistemi gjyqësor, do ta quaja tepër i korruptuar, në Kosovë, të cilit duhet t' ia ndryshojmë mundësinë dhe duhet ta vëmë nën një kontroll, siç e kanë vendet perëndimore dhe, të mos eksperimentojmë, siç e tha edhe zoti Kuçi, me modele të cilat realisht e bllokojnë edhe të drejtën e të akuzuarve, edhe të drejtën e atyre që mbrohen edhe ua mundësojnë gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve, që të ndërtojnë një sistem tepër të sofistikuar, çfarë e kanë, korruptimi në Kosovë.

Zoti ministër, të dëgjova me vëmendje për vërejtjet që i keni në sistemin gjyqësor. Në qoftë se, ju prisni që Parlamenti të marrë nisma në këtë formë siç e thatë ju, unë nuk e shoh si të mundur, sepse shumica e deputetëve nuk janë specialistë të fushës, por unë besoj që të metat e sistemit gjyqësor, si Ministri e Drejtësisë dhe si ekspertë, që mund të keni, duhet t' i evidentoni dhe t' i sillni në Parlament me urgjencë për t' i miratuar nga deputetët e Parlamentit të Kosovës.

Nuk e besoj që ka deputetë në këtë Parlament, që nuk do të votojë një ligj i cili e pengon korrupsionin në drejtësi, i cili e pengon mosfunksionimin e legjislacionit, ose mos pamundësinë e zbatimit të ligjeve të miratuara në këtë Kuvend dhe nuk e besoj, që ka deputetë që voton kundër cilitdo ligj, që lufton korrupsionin dhe krimin e organizuar në Kosovë.

Jam plotësisht dakord me vërejtjet, kryesisht të shumë vendeve të punës që tha zonja Haxhiu. Unë do ta dalloja, në këtë rast, nëpunësin e shtetit, ose shërbëtorin e shtetit, më mirë të themi, nga privati. Edhe nëpunësi i shtetit edhe gjyqtar në shtet edhe mësimdhënës në fakultete private

nuk shkon. Edhe profesor në Universitet edhe prokuror nuk shkojnë bashkë. Nuk e besoj që në vendet perëndimore, në të cilat, ose për të cilat po pretendojmë që të jemi pjesë e tyre, që ka ndonjë rast të tillë. Në qoftë se, ka ndonjë gjeni në drejtësi, atëherë mund të mbajë leksione private, mund të mbajë leksione për të gjithë prokurorët, për të gjithë gjyqtarët, por që të shkojë të japë mësim me çantë në dorë dy-tri herë në javë dhe prapë të vijë në sallën e gjyqit, mendoj se nuk është në rregull.

Prandaj, zoti ministër, po të drejtohem ty, sepse përgjegjësitë në raport me këta njerëz këtu dhe me qytetarët e Kosovës, sa i përket kësaj për legjislacionin e keni ju. Shihni mundësitë, së bashku me njerëzit, me ata prokurorë, me ata juristë, me ata gjyqtarë, që duan të ndërtojnë drejtësinë dhe jo me ata gjyqtarë dhe me ata prokurorë, që duan t'i mbajnë vendet e punës, që të ndërtoni një sistem kontrolli të fuqishëm dhe t'ua pamundësoni, së pari atyre dhe t'ua pamundësoni jo vetëm politikanëve, por t'i pamundësoni akuzat kundër sistemit të drejtësisë në Kosovë. Dhe, për t'i pamundësuar këto akuza që vijnë jo nga ne, në fund të fundit, aq sa po vijnë për çdo ditë në raportet ndërkombëtare, që i bëjnë për Kosovën, do një përkushtim vërtet të madh, do një veprim të dhembshëm, do ta quaja, në raportet ndërnjerëzore, kur është fjala për veprimet në drejtësi, por kjo çështje duhet të përfundojë tani, në qoftë se duam neve të flasim edhe për liberalizim të vizave, në qoftë se duam të flasim edhe për integrim të Kosovës në Bashkimin Evropian.

Prandaj, unë po them që përgjegjësia, ju e dini, edhe publike shumë herë ka rënë mbi juve. Nuk dua të them, sa di unë dhe sa jeni përgjegjës për këtë, sepse nuk është e domosdoshme as t'ju mbroj juve dhe, as t'i mbështes ata që ju kanë akuzuar, por mundësia për të bërë dhe për ta lëvizur këtë gjendje që e kemi, është së pari në duart tuaja dhe unë besoj fort tek deputetët e Parlamentit të Kosovës dhe tek mbështetja e të gjithë qytetarëve të Kosovës, që do të jetë për juve dhe për nismën që do ta bëni.

Nuk më vjen mirë, që e thatë: “nuk është ligji i përsosur”. Në qoftë se, nuk është i përsosur ligji, të lutem tërhiqe ligjin, që të mos e votojmë. Lojë fjalësh në Parlament nuk duhet të bëhet, ose miratojmë ligj, që mendojmë se është i mirë, ose nuk e miratojmë fare. Andaj, mbështetjen e keni, urdhëroni bëjini ligjet, buxhet keni, mundësitë i keni, bëjini ligjet që duhet miratuar, se njëra ndër pengesat e mëdha, dua të them edhe për integrim të Kosovës edhe për raportet që vijnë negative, është pikërisht kjo. Dhe, më po besoj që edhe ju s'keni vullnet që ta toleroni dhe duroni gjendjen që e kemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Në fillim të fjalës së ministrit, ai tha që ka pasur një tendencë të balancimit të kërkesave ndërmjet institucioneve, që kanë qenë të përfaqësuar në grupet punuese. Unë nuk e di nëse kjo qëndron, për shkak se pikërisht anëtarët edhe të Këshillit Gjyqësor të Kosovës edhe atij të Këshillit Prokurorial të Kosovës, kanë thënë që Komisioni për Legjislacion duhet ta adresojë, në mënyrë që mos të lejojë as gjyqtarët e as prokurorët, që të jenë profesorë ose ligjërues në universitete, qoftë publike dhe zyrtare.

Mirëpo, edhe nëse kjo nuk qëndron dhe nëse ata paskan thënë, që kjo nuk duhet t'u mohohet, nuk po bëhen ligjet për interesat personale as të gjyqtarëve, as të prokurorëve, mirëpo, ligjet po bëhen për të kontribuar edhe në interesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës po edhe për shtetin e Kosovës, jo as për Këshillin Gjyqësor as për atë prokurorial.

Pra, mendoj që këtë Komisioni për Legjislacion duhet ta shqyrtojë me seriozitetin më të madh.

Sa i përket raportimit të Këshillit Gjyqësor në Kuvend, po është e vërtetë që me Kushtetutën e Republikës së Kosovës një herë në vit Këshilli Gjyqësor i Kosovës i drejtohet Kuvendit. për aq vite sa jemi deputetë, po flas prej kur Lëvizja "Vetëvendosje" është në institucionet e Republikës së Kosovës, vetëm njëherë Këshilli Gjyqësor i Kosovës i është drejtuar Kuvendit.

Pra, edhe përkundër kësaj kategorie kushtetuese, ka refuzuar që të sjellë raport njëherë në Komisionin për Legjislacion e më pas ta njoftojë Kuvendin për punën e tij. Për këtë arsye, para dy javësh i kam shkruar dhe i kam kërkuar raport me shkrim për punën e Këshillit Gjyqësor. Dhe, sa herë flasim për Këshillin Prokurorial të Kosovës nuk ka se si të mos na kujtohen skandalet e bandave dhe grupeve klanore brenda Këshillit Prokurorial. E për këtë, zoti ministër, ju jeni përgjegjësi kryesor, sepse keni qenë ose jeni anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Dhe, nuk mund të kontribuojmë në sistemin e drejtësisë vetëm me ligje, mirëpo nevojitet vullnet për t'i zbatuar këto ligje dhe për ta lënë të lirë sistemin e drejtësisë, të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

Mirëpo, kjo nuk mund të bëhet për sa kohë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: OK. Faleminderit! Po gjithsesi, po edhe Donika dëshiron të reagojë, apo ministër, dëshironi? Donikë, a ke replikë? Donika ka replikë.

Atëherë, Ministri i Drejtësisë e ka fjalën. Donika e ka tërhequr. Urdhëro, zoti ministër i Drejtësisë.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryetar!

Dëgjova me vëmendje zotin Haliti dhe dua të them, që disa debate të tilla i kemi pasur edhe më herët dhe, disa prej tyre besoj kanë reflektuar edhe në këto ligje.

Por ajo që dua të them, duhet ta pranojmë një fakt të gjithë. Është hera e parë, që ne po e bëjmë një tranzicion, ose marrje të kompetenca në fushën e drejtësisë dhe ky tranzicion prej EULEX-it në institucionet vendore do ta qes në sipërfaqe, sikurse ka filluar të qesë edhe fuqinë tonë, po edhe dobësitë tona.

Deri më sot, deri më 15 qershor, respektivisht të vitit të ardhshëm, ne të gjithë do të jemi ata që do ta shohim sa e kemi fuqinë, që ai proporcioni i zvogëlimit të kompetencave të EULEX-it dhe marrjes sonë, mos ta lejojë ndonjë hendek në drejtësi.

Dhe, natyrisht, deri më tani të gjithë ne, përfshirë edhe mua, për çdo gjë kemi adresuar edhe kreditet po edhe fajësinë te të tjerët, një kohë te EULEX-i e më herët te UNMIK-u. Unë mendoj, që tash ka ardhur koha që të marrim përgjegjësinë në duart tona. Dhe, marrja e përgjegjësisë në duart tona do të jetë edhe vërejtja e atyre dobësive, që u përmendën dhe do të dalin dobësi edhe më të mëdha.

Mos të mendojë dikush, që Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial është më ndryshe prej të tjerëve. As atje nuk janë krejt engjëj, as këtu as diku tjetër dhe, unë mendoj se kjo reflektohet. U përmend në Këshillin Prokurorial dhe më ka ardhur keq për ato skena që kanë ndodhur. Por duhet ta them një fakt, sa herë që ky vend, mbani mend, ka për të zgjedhur kryeprokuror do të ketë nga pak dridhje. Mos mendoni që kryeprokurori ka për të shkuar bash sikur në vaj dhe, kjo ka me qenë e vërtetë. Sikur që te modelet, që përmendi zoti Haliti, ne kemi telashe që të bëjmë modele, ngase ne kemi edhe faktorë të tjerë, që na i determinojnë.

Po e zëmë BE-ja, EULEX-i e ai tjetri, se modeli, po e marr shembull, që thotë dikush, mos harroni, dy vende po ua marr shembull: Kroacinë dhe Slloveninë. Ne e kemi pasur një sistem juridik të përafërt për disa vjet me ta, ata janë në BE dhe ne kemi ambicie të njëjta. Ministri i Drejtësisë, respektivisht Qeveria ka kompetencë direkt në zgjedhjen e prokurorëve dhe të kryeprokurorit të shtetit.

Por, ne s'e kemi marrë atë model. Edhe në Gjermani ka kompetencë të tillë, edhe në SHBA. Ne jemi munduar të largohemi, për shkak të ambientit politik, ku jetojmë ne, por me kalimin e kohës duke përshtatur ambientin juridik, politik e tjerë, ne duhet të bëjmë edhe veprime, që do t'i përshtaten ambientit ku jemi.

Por, ajo që dua ta them, ne duhet ta kemi të qartë, çështja e drejtësisë shkon paralelisht edhe me zhvillimin ekonomik edhe me integrimet evropiane. Nuk ka në këtë vend vetëm sundim i ligjit, pa u zhvilluar edhe ekonomia dhe integrimet.

Pse po e them këtë? Ekonomia ndihmon për zhvillimin e këtij sistemi, me mbështetje financiare dhe tjetër edhe ky sistem i ekonomisë. Integrimet evropiane janë tullë, që nga pak na bien në kokë neve, për t'i bërë disa reforma e që nuk pajtohen lehtë.

Unë po e përsëris, nuk kam asnjë dilemë, që prokurorët dhe gjyqtarët të mos japin mësim diku tjetër, por unë kam dëshirë që të barazohen sistemet. Dhe, kur themi për ta "s'bën", mos të bëjë për asnjërin. Ky është qëllimi im dhe, unë besoj, si ministër e kam obligim ta bëj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim! Votojmë tash!

76 deputetë kanë votuar, 75 për, 1 abstenim.

Konstatohet se e Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime për seancën plenare, e cila do të mbahet më 28 maj 2015.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Legjislacion ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

Ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçin, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Kryeministër,

Deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni, që të prezantoj para jush Projektligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Duke marrë parasysh nevojën e plotësimit të kriterëve për liberalizimin e vizave dhe po ashtu, nevojën për harmonizim të këtij Projektligji edhe në projektligjin, që ka të bëjë me Këshillin Prokurorial të Republikës së Kosovës dhe anasjelltas, kemi propozuar këtë projektligj.

Dhe, më lejoni që t'i theksoj ndryshimet kryesore, që janë propozuar:

E para - janë paraparë kompetenca shtesë për Këshillin, që ai të nxjerrë rregullore, që ndërlidhen me funksionimin e sistemit gjyqësor, me përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve dhe rregulloreve tjera, që kanë për qëllim fushëveprimin dhe efikasitetin në këtë Këshill.

Çështja e dytë - garantohet me dispozita, se anëtarët e Këshillit nuk mund të përfitojnë nga pozita e të qenit anëtar i Këshillit, me qëllim të ngritjes së tyre në detyrë. Pra, me fjalë të tjera, për aq sa janë anëtarë të Këshillit, nuk mund të lëvizin nga një pozitë në pozitën tjetër në sistemin juridik të Kosovës.

Po ashtu, një ndër aspektet me rëndësi në pavarësinë e gjyqësorit është edhe pavarësia financiare. Ne kemi propozuar, që përveç se do ta bëjë menaxhimin e vet të buxhetit edhe do ta ketë mundësinë, që ta propozojë drejtpërdrejtë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe profesionalizmit në punë, janë qartësuar dispozitat, që lidhen me mundësinë e shkarkimit të anëtarëve të këshillit, për moskryerjen e detyrave të tyre, apo performimi në kundërshtim edhe me Kushtetutë edhe me ligjet e Republikës së Kosovës.

Në kuadër të Këshillit është paraparë mundësia e themelimit të Komisionit për vlerësimin e performansës së gjyqtarëve, vlerësim i cili do të jetë bazë për ngritjen dhe avancimin e gjyqtarëve apo edhe për uljen dhe shkarkimin e tyre, gjatë pozitive që mund t'i kenë.

Me qëllim që të jetë më efikas, kemi paraparë edhe mundësinë e masave disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë në Republikën e Kosovës, po edhe mundësinë e tyre që t'i bëjnë ankimumet në organet kompetente.

Ju ftoj, që pas propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve tuaja, ta miratojmë në parim. Faleminderit, për votimin paraprak dhe po ashtu, në komisione të bëjmë përmirësimet e duhura. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Pas prezantimit të projektligjit, hapim diskutimet në parim. Në emër të Grupit, të Komisionit Funkcional për Legjislacion, fjalën e ka kryetarja e Komisionit, zonja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2015, Komisioni për Legjislacion ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe, Komisioni i ka rekomanduar Kuvendit që ta përkrah në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e grupeve parlamentare. E ka fjalën Selviqe Halimi nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe, ka vërejtur se në këtë projektligj është bërë ndryshim dhe plotësim, si në aspektin përmbajtësor ashtu edhe në aspektin teknik dhe, si të tillë e mbështesim projektligjin në parim dhe do të kontribuojmë në fazën e amendamenteve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën Armend Zemaj, nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së ka shqyrtuar Projektligjin për Këshillin Gjyqësor, ndryshim-plotësimin. Pak a shumë është në nuancat e njëjta, atë që folëm për Ligjin për gjykatat, qoftë te përgjegjësia, por qoftë edhe te pavarësia për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, por edhe ajo që po e quajmë pavarësi financiare.

Te aspekti financiar, e përmendi edhe ministri, unë mendoj që këtu duhet të kemi harmonizim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, sepse buxheti i asnjë organizate buxhetore nuk mund të dërgohet i pavarur, por duhet të shkojë përmes Ministrisë së Financave. Ne pajtohemi, që kjo çështje të jetë në nivelin, që e ngritë atë që mund të quhet pavarësi financiare dhe që ndërlihd edhe me atë që ne po e quajmë, qoftë me pagat që e përmenden të vendosen në shtylla të njëjta edhe atë që e përsëriti ministri, që një parim të vlejë për të gjithë.

Unë mendoj që këtu më shumë kemi të bëjmë me parimin e përgjegjësisë, sesa me parimin ligjor, sepse edhe në Kuvendin e Kosovës e ka një kod të mirësjelljes, po ashtu edhe me Ligjin për konfliktin e interesit, dihet se ku lejohen edhe deputetët, pavarësisht asaj e cila nuk respektohet, qoftë edhe mënyra e votimit, shpeshherë kemi pasur edhe këtu deputetë të caktuar, që përkundër interesave biznesore apo familjare që kanë pasur, kanë votuar për ose kanë insistuar që ajo të shkojë dhe asnjëherë nuk është respektuar ajo.

Për këtë arsye, ne nuk mund të vendosim standarde vetëm të përgjegjësisë morale, por ajo duhet të jetë e sanksionuar me ligj dhe për këtë unë mendoj që shtylla e Gjyqësorit, Ekzekutivit dhe Legjislativit të jetë e barabartë me paga dhe kjo do t'i heqë dilemat atëherë edhe të punësimit të dyfishtë, por qoftë edhe të asaj që mund të ketë nuanca, se kush është mbi njëri-tjetrin.

Grupi Parlamentar përkrah këto ndryshime, që janë bërë. Ajo që na pëlqeu është edhe sanksionimi me këtë ligj edhe stema, që do të jetë në të gjitha vendimet e gjyqësorit, në gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe kjo e justifikon edhe përkrahjen tonë për ndryshimet dhe për marrëveshjet e arritura në marrëveshjen që është bërë për gjyqësorin në kuadër Kosovë-Serbi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Zemaj. Tani fjalën e ka Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Projektligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Po i përmend fillimisht dy vërejtje, që janë më përmbajtjesore dhe më pas i kam disa teknike.

Te ky projektligj mbetet problem i pa adresuar raportimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që e përmenda më përpara, pavarësisht faktit se në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, thuhet se Këshilli Gjyqësor i Kosovës i drejtohet njëherë në vit Kuvendit për punën e tij, në këtë projektligj nuk janë specifikuar, ose nuk janë saktësuar procedurat, ose afatet kohore për raportim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Kuvend.

Për këtë arsye, mendoj se duhet të jetë 31 marsi i vitit kalendarik, ashtu siç është edhe për institucionet tjera të pavarura.

Problem tjetër mbetet edhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, që vijnë nga Kuvendi. Kushtetuta e Republikës së Kosovës thotë, që 8 anëtarë të Këshillit Gjyqësor i zgjedh Kuvendi, mirëpo deri më tani nuk janë të qartësuar procedurat, se si i zgjedh Kuvendi, në fakt s'i propozon Kuvendi, nëse i zgjedh Kuvendi, kush i propozon? Në mungesë të këtyre procedurave, në të kaluarën, grupet parlamentare kanë bërë pazare njëra me tjetrën, duke dërguar njerëz të tyre në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Për këtë arsye, mendoj që është tepër e rëndësishme, që për sa kohë kemi këtë dispozitë kushtetuese dhe kompetencë të Kuvendit, të specifikohen edhe procedurat, se si propozohen, ose kush i propozon këta anëtarë për KGJK.

Për këtë arsye, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” pata kërkuar në fillim të këtij mandati, që të jetë një konkurs publik, ku do t’u mundësohet të gjithëve që kanë gatishmëri, ose ambicie për të qenë anëtar i Këshillit Gjyqësor, që të kandidojnë në këtë konkurs publik.

Në këtë projektligj vërehet tendenca, që të bëhet centralizimi, sa i përket punësimit të stafit administrativ në gjykata. Ne kemi dyshime që nëse mbetet kështu, por çdo konkurs dhe nevojë duhet të shpallet, pra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, kështu ekziston edhe një tendencë, pra që të përfitojnë njerëzit me influencë brenda Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Në nenin 14, paragrafi 3, ku flitet për Komisionin për vlerësimin e performansës së gjyqtarëve, thuhet që procedura nuk do të fillohet dhe zbatohet në Komision, pasi të kalojë afati njëvjeçar nga njoftimi i pranuar në zyrën e prokurorit disiplinor, për shkeljen e supozuar dhe pesë vjet nga dita e shkeljes së supozuar.

Në rastin, kur Zyra e prokurorit disiplinor ka lejuar parashkrimin e lëndës, ose shtyrjen e dërgimit të saj për gjykim tek Komisioni Disiplinor, gjë që rezulton ta pamundësojë këtë të fundit për ta gjykuar atë sipas këtij ligji, Komisioni detyrohet që ta njoftojë Këshillin Gjyqësor për një lëshim të tillë të Zyrës së prokurorit disiplinor.

Pra, mendoj që është tepër e rëndësishme, që të adresohet kështu: “Mbi një lëshim të tillë, Këshilli kërkon përgjegjësi zyrtare nga zyra e prokurorit disiplinor edhe nëse për një të tillë nuk merret përgjigja e arsyetuar, një lëndë të tillë detyrueshëm ia adreson prokurorit të shtetit për hetim eventual të keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga zyra e prokurorit disiplinor”, sepse nëse lihet kështu është e paqartë.

Gjithashtu, në nenin 15.5 thuhet që këshilli gjatë vendosjes për ankesë mund të refuzojë ankesën, vërtetojë ose ndryshojë vendimin e Komisionit disiplinor. Vendimi i këtillë i Këshillit duhet të jetë i arsyetuar, sa u takon provave të administruara nga të dyja palët, interpretimit të shkeljeve të pretenduara dhe masës së dënimit të argumentuar, që do t’i përshtatej arritjes së qëllimit të përcaktuar nga ky ligj.

Gjithashtu, në nenin 16, paragrafi 2, pra ku flitet për mbrojtjen gjyqësore, është në kundërshtim paragrafi 1 me paragrafin 2, sepse rezulton se dy gjykata, si ajo Themelore dhe Supreme, janë kompetente për të njëjtën çështje dhe në të njëjtën kohë. Konsideroj që vendimet e Këshillit, për të cilat Këshilli vendos si instancë rregulluese e profesionit të gjyqtarit dhe sistemit gjyqësor, përkatësisht meritës së zgjedhjes, promovimit, transferim dhe disiplinimit të gjyqtarëve dhe rregullimit të profesionit të tillë, mund të ankimohen vetëm në Gjykatën Supreme, sa u takon kritereve të përcaktuara me këtë ligj dhe respektit të drejtave personave të atakuar me një vendim të tillë.

Ndërsa, një koleg prej tre gjyqtarësh i Gjykatës Supreme, le të veprojë si shkallë e parë, për një vlerësim të ligjshmërisë për një vendim të tillë, kurse Gjykata Supreme në përbërjen e plotë të saj, të veprojë si shkallë e dytë ndaj vendimit të kolegjit të saj.

Pra, këto janë disa nga vërejtjet e Lëvizjes “Vetëvendosje”, mirëpo ne në parim do ta përkrahim këtë projektligj dhe më pas do t’i përpilojmë amendamentet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Donika Kadaj-Bujupi dhe nuk kemi më të lajmëruar askënd.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka disa vërejtje parimore në Projektligjin për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Këshillin Gjyqësor.

Në fillim, më lejoni të them që këto ndryshime nuk janë shumë rrënjësore, më shumë janë modifikime kozmetike, të cilat nuk sigurojnë një funksionalizim të Këshillit Gjyqësor në kuptimin e pavarësisë së tij nga ekzekutivi dhe ndërhyrja e vazhdueshme e cila ka ndodhur deri tani, nuk sigurohet se do të jetë ndryshe, ndërhyrje kjo që ka nxjerrë në sipërfaqe jashtëzakonisht shumë skandale. Të gjitha këto në disfavorin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.

Një situatë të ngjashme e kemi edhe përkitazi me propozimet e radhës, do të thotë të Këshillit Prokurorial, të cilat do t’i diskutojmë ndërkohë. Ndërkaq, në anën tjetër është një qortim i përgjithshëm, jo vetëm për këtë projektligj, sepse tekstet në tri gjuhët nuk janë të harmonizuara dhe si të tilla, në praktikë, pashmangshëm do të shkaktojnë dilema dhe hutime gjatë zbatimit, si dhe komentime profesionale të ndryshme. Dhe, ne e dimë nga e kaluara, se si janë komentuar ose se si janë interpretuar ligjet në të tri gjuhët. U mor vesh, kjo zakonisht ka shkuar në dëm të rendit juridik të vendit tonë.

Vërejtjet dhe propozimet konkrete ndërlidhen edhe me nenin 4, nenin 2, nenin 7 dhe nga këtu kemi nxjerrë amendamentet të cilat do t’i procedojmë pranë Komisionit përkatës, ndërkohë nuk konsiderojë që ne as s’mund të flasim në parim ose të bëjmë krahasime me projektligjet në shtetet tjera, sidomos jo në SHBA dhe Gjermani, siç u përmend këtu, sepse në asnjërin prej këtyre vendeve, madje as në shtetet në rajon, ku demokracia është goxha e brishtë, nuk ndodh që për shembull, një kryetar i një komune të ikë nga përgjegjësia dhe veprat penale dhe të bëjë shaka nga shtetet e ndryshme duke thirrur partinë e tij, e cila vazhdon të jetë në pushtet.

Do të thotë, ne jemi aq larg, sa i përket sundimit të ligjit, sa që Kosova të krahasohet, ose të provojmë që të përputhim projektligje të caktuara me një mentalitet të tillë qeverisës, është gati krejt e pamundur.

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë, janë lajmëruar edhe dy diskutues në emër të grupeve parlamentare. Por, ju kisha lutur, për hir të korrekhtësisë ndaj publikut, lajmërohuni gjatë kohës kur i kemi në shqyrtim. E ka fjalën Shukrije Bytyqi nga Grupi Parlamentar “Nisma”.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” e ka shqyrtuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe për shkak të rëndësisë që ka, ne do ta përkrahim në parim, ndërsa, vërejtjet dhe amendamentimet do t’i dërgojmë me kohë në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Danush Ademi nga “6+”-i e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Në parim do ta përkrahim këtë projektligj. Vërejtjet do t’i dërgojmë në komisionet përkatëse.

KRYETARI: Faleminderit, Danush! Ministri i Drejtësisë, e dëshiron fjalën? Jo!

Atëherë, të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Ndërkohë, ne thërrasim deputetët që eventualisht janë duke pirë kafe jashtë. Të presim vetëm edhe pak, se nuk kemi kuorum, jemi vetëm 55 deputetë në sallë. Presim, ose do të vazhdojmë...

Atëherë, në orën 14:00 do ta kemi votimin, ne do të vazhdojmë me pikën tjetër. Ndërkohë, ne po i lexojmë në parim, po i shqyrtojmë, në ora 14:00 do ta kemi votimin. Ta kemi parasysh!

Të gjithë deputetët, që janë të pranishëm këtu edhe ata që nuk janë të pranishëm, në ora 14:00 bëhet votimi i projektligjeve.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

Ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçin, që para deputetëve ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuari kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni të paraqes para jush ndryshimet e plotësimet e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Republikës së Kosovës.

Me këto ndryshime, që ndërlidhen me pavarësinë dhe funksionalitetin e sistemit prokurorial në përgjithësi dhe, në veçanti në funksionimin e Këshillit Prokurorial të Republikës së Kosovës. Më lejoni t’i theksoj ndryshimet elementare apo esenciale, të cilat i kemi paraparë.

E para ka të bëjë me pavarësinë e funksionimit të Këshillit Prokurorial, qoftë pavarësia në funksionim, qoftë ajo pavarësia në emërimin e tyre dhe tani, në kuadër të përbërjes së Këshillit do të jenë 14 anëtarë, pjesa dërmuese 10 prej tyre do të jenë anëtarë prokurorë, përfshirë nga

prokuroritë themelore të Republikës së Kosovës, nga Prokuroria Speciale, Prokuroria e Apelit dhe Zyra e Prokurorisë së shtetit.

Më lejoni të theksoj po ashtu, se në kuadër të këtij Këshilli Prokurorial ministri i Drejtësisë nuk do të jetë anëtar ex officio, siç ka qenë deri më tani. Po ashtu, Këshilli Prokurorial do ta zgjedhë kryetarin e vet nga radha e prokurorëve.

Këshilli Prokurorial është paraparë që të ketë edhe pavarësi buxhetore, jo vetëm në menaxhimin e buxhetit, që ka pasur deri më tani, por të përgatitë propozimin e buxhetit vjetor dhe këtë t'ia dërgojë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Natyrisht, këtu është paraparë që të themelohen edhe një serë komisionesh për funksionimin e këtij këshilli, siç është: Komisioni për Vlerësimin e Performansës së prokurorëve, funksioni i tyre që do të jetë në kuadër të Këshillit Prokurorial, të vlerësojë punën e prokurorëve dhe ky vlerësim do të jetë bazë për adresimin, avancimin, por edhe shkarkimin apo ngritjen në detyrë të këtyre prokurorëve.

Më lejoni të them që në mandatin fillestar prej 3 vjetëve është obligative që të bëhet dy herë trajnimi fillestar, por njëkohësisht edhe vlerësimi për këta prokurorë, sikur që vlerësimi i performansë së prokurorëve me mandat të përhershëm do të bëhej çdo 3 vjet.

Po ashtu janë paraparë edhe komisionet për çështje normative, për buxhet e financa, për personel, për administrimin e prokurorive, për komision disiplinor dhe komisione të tjera që ka nevojë Këshilli t'i themelojë.

Ne kemi qenë të kujdesshëm që të bëjmë edhe mbrojtjen gjyqësore të drejtave të prokurorëve ndaj vendimeve përfundimtare të Këshillit, për të cilët për konflikt administrativ do të drejtohen tek organi kompetent.

Më lejoni të theksoj që edhe administrata e sistemit prokurorial është paraparë të funksionojë në kuadër të Këshillit Prokurorial dhe është paraparë që të harmonizohet në tërësi me administratën e prokurorive të Republikës së Kosovës, por edhe me ata të sistemit gjyqësor dhe do të kenë pavarësisë, respektivisht njëri i përgjigjet Këshillit Prokurorial dhe tjetra Këshillit Gjyqësor.

Ju ftoj që t'i jepni, vërejtjet e sugjerimet dhe pastaj edhe ta miratojmë në parim sot, dhe me ndryshimet tjera në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit zoti ministër. Pas këtij prezantimi të projektligjit, e hap debatin për diskutim në parim. Në emër të Komisionit funksional për Legjislacion, fjalën e ka Agim Ademaj.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Komisioni i Ligjeve, në mbledhjen e vet të mbajtur me 15.5.2015 e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit numër 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe

Kuvendit i paraqet rekomandimin që ky projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të aprovohet, do të thotë të kalojë në leximin e parë.

Mendojmë se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore dhe Komisioni i Ligjeve e përkrah këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, sipas radhitjes nuk ka të paraqitur asnjë. Nga Partia Demokratike e Kosovës, Nezir Çoçaj e ka fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti ministër,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe si të tillë do ta mbështesim, ndërsa vërejtjet e sugjerimet tona do t'i paraqesim në punën e komisioneve dhe gjatë leximit të dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, zoti Agim Ademaj e ka fjalën.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë do mundohem me pak fjalë- Ligji për Këshillin Prokurorial është analizuar në Grupin Parlamentar të LDK-së, parimisht e përkrahim këtë projektligji.

Nga memorandumit shpjegues shihet atje, zoti ministër, që ajo që e ka shtyrë Ministrinë e Drejtësisë t'i bëjë këto ndryshime, është pjesa ku nuk ka mund të zbatohet ky ligj ose ka pasur vështirësi në zbatimin e tij dhe është intervenuar në ato segmente.

Mendojmë se edhe pse është afati i shkurtër, në Komisionin e Ligjeve do të përpiqemi ta plotësojmë ose amendamentojmë këtë projektligj për të dalë sa më cilësor, edhe pse prapë po them, është një kohë e shkurtër dhe besoj që edhe ministri dhe ekspertët që i kemi ftuar në grupe punuese rreth kësaj pakoje, do të na ndihmojnë dhe do të nxjerrim një ligj sa më cilësor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lëvizja “Vetëvendosje”, zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe fillimisht po ndalem te një çështje, që ka të bëjë me anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës, neni 65 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, te kompetencat e Kuvendit.

Kuvendi zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë. Pra, deri më tani, asnjëherë Kuvendi nuk i ka zgjedhur anëtarët e Këshillit Prokurorial, edhe përkundër faktit që është dispozitë kushtetuese.

Gjithashtu, edhe ky projektligj unë konsideroj që është në shpërputhje me Kushtetutën, sepse nëse Kushtetuta thotë që anëtarët e KPK-së i zgjedh Kuvendi, ky nuk po thotë kështu, kështu që ligji duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe përbërja e Këshillit

Prokurorial, pra të jetë në përputhje me Kushtetutën ashtu sikur që është edhe përbërja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sepse Kuvendi i zgjedh anëtarët, disa prej anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, mirëpo edhe përkundër kategorisë kushtetuese asnjëherë nuk i kemi zgjedhur anëtarët e Këshillit Prokurorial.

Pra, mendoj se gjatë kësaj jave në procedura të shqyrtimit të këtij projektligji që ta adresojmë edhe këtë çështje.

Tjetra ka të bëjë me Raportin e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Edhe përkundër skandaleve që e kanë mbërthyer Këshillin Prokurorial të Kosovës, asnjëherë i njëjti nuk ka dhënë llogari para asnjë institucioni për të gjitha ato skandale që e kanë mbërthyer këtë Këshill. Pra, mendoj se në këtë projektligj duhet të precizohet që Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet ta njoftojë Kuvendin për punën e tij.

Le të mos e bëjmë raport, sepse po duket pak si ndërhyrje në pavarësinë që nuk e ka, sepse pavarësinë e ka në letër e jo në praktikë, mirëpo megjithatë duhet ta precizojmë se duhet ta njoftojë Kuvendin për punën e tij.

Gjithashtu, sa i përket kompetencave të Këshillit Prokurorial mendoj që duhet të shtohen edhe dy paragrafë të tjerë, garantimin e një sistemi të hapur dhe të përgjegjshëm të administrimit të vendimeve të saj dhe të tërë sistemit prokurorial dhe tjetra raportimin përball publikut për zbatimin e objektivave të saj të përcaktuara në mënyrë specifike dhe bazuar në indikatorët e matshëm çdo 6 muaj. Pra, mendoj se këto dy paragrafë duhet të përfshihen në kompetencat e këshillit.

Gjithashtu, të shtohet paragrafi 1.5, pra te neni 11, me qëllim të garantohet pluralizmi i KPK-së dhe ruajtja nga bartja e shumë pozitive nga të njëjtit njerëz.

Anëtarët - prokurorë të këshillit nuk mund të bartin paralelisht pozitën e kryeprokurorit të ndonjë prokurorie themelore të apelit apo edhe speciale.

Gjithashtu në nenin 23 paragrafi 1 dhe 2, paragrafi 1 është në kundërshtim me paragrafin 2 sepse këtu thuhet që Komisioni përbëhet prej 2 anëtarëve të Këshillit e në paragrafin 1 prej 3 anëtarëve të këshillit. Tash, a përbëhet nga 2 anëtarë apo nga 3 anëtarë? Pra mendoj se kjo duhet të specifikohet dhe të jetë e qartë se sa anëtarë i ka dhe propozoj që 1 anëtar i Komisionit të jetë anëtar i këshillit, 1 anëtar të jetë prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe 1 anëtar të jetë prokuror në Prokurorinë e Apelit.

Pra, këto janë disa vërejtje nga Lëvizja “Vetëvendosje” në këtë fazë dhe sigurisht se do të marrim edhe opinionin e shoqërisë civile dhe grupeve tjera të interesit në mënyrë që të kemi një ligj sa më të mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës fjalën e ka Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Të nderuar kolegë deputetë,

Për të qenë korrekte me opinionin dhe me qytetarët, duhet edhe një herë të theksoj se në fakt ky diskutim sot nuk po ndodhë me qëllim që të përmirësojmë gjendjen e gjyqësorit, prokurorit ose në përgjithësi sundimit të ligjit në vend, por në fakt që të përmbushim apo të plotësojmë një raport për përmbushjen e kriterëve për liberalizim që Kosovës i kërkohet diku deri më 28 maj. Pra, është njëfarë improvizimi i cili po ndodh këtu sot, ku shpejt e shpejt po kërkohet nga ne që të japim vërejtjet tona për një mori ligjesh të cilat, thënë të vërtetën, është e pamundur brenda 24 orëve për t'i vlerësuar.

Do të punojmë me grupet e ekspertëve për atë sa ka kohë, sepse dihet që i 28-ti është shumë afër dhe të japim edhe rekomandimet tona për plotësim-ndryshim, por po dua edhe një herë të theksoj se nuk bëhet fjalë që substancialisht ka ndonjë vullnet politik që të punojmë në kuptimin e përmirësimit të gjendjes çfarë e kemi në Kosovë, por më tepër për të plotësuar një raport i cili kërkohet me qëllim të plotësimit të raportit ose asaj që quhet, do të thotë, një përmbushje e kriterëve për liberalizim të vizave, e cila po vonohet për faktin se institucionet dhe Qeveria po punojnë shkel e shko dhe pikërisht për shkak të vonesave dhe këtyre veprimeve improvizuese nuk po ndodh substancialisht asgjë në kuptimin e përmirësimit ose ecjes përpara drejt liberalizimit.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Nisma, Haxhi Shala.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne si Grup Parlamentar e përkrahim në parim ligjin, duke e kuptuar rëndësinë e këtyre ligjeve që kanë ardhur kaq shpejt dhe në një kohë shumë të shkurtër, por besoj se në Komisionin paraprak ne do të kontribuojmë dhe japim komentet tona lidhur me plotësimin e këtyre vërejtjeve të cilat u dhanë nga kolegët tanë, në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën Danush Ademi, nga “6+”, e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në parim do ta përkrahim këtë projektligj, kurse vërejtjet e sugjerimet tona do t'i dërgojmë në komisionet përkatëse.

KRYETARI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë, nëse e do fjalën, por po shoh që s'ka reagim.

Atëherë, të nderuar deputetë, do ta presim edhe këtë pikë....

(Ndërhyrje)

Në orën 14:00, por do të ishte mirë që shefat e grupeve parlamentare në orën 13:30, se po e shohim nuk do të kemi punë deri në 14:00. Besoj se në 13:30 e përfundojmë.

Atëherë, kalojmë në pikën vijuese:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit Komisioni Funkcional për legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

Ftoj ministrin e Drejtësisë, zotëri Hajredin Kuçi që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që të prezantoj para jush plotësim-ndryshimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit.

Edhe Projektligji për Prokurorin e shtetit ka paraparë një lloj të ndryshimeve, të cilat do të jenë në përputhje të plotë me natyrën e punës së prokurorëve në Republikën e Kosovës, por qëllim esencial do ta ketë rritjen e efikasitetit të punës së tyre dhe nivelin e lartë të performansës në tërë sistemin prokurorial, dhe në veçanti në Prokurorinë e Shtetit të Republikës së Kosovës.

Prandaj, më lejoni t'i theksoj ndryshimet qendrore që kemi menduar t'i bëjmë.

E para, janë ridraftuar dispozitat që ndërlidhen me punën dhe funksionimin e Kryeprokurorit të shtetit, duke paraparë kështu në mënyrë të qartë kompetencat e Kryeprokurorit të shtetit si kreu i Prokurorisë së vendit tonë.

Në kuadër të detyrës së tij për të siguruar një sistem efikas, është paraparë mundësia e nxjerrjes së instruksioneve dhe udhëzimeve për punën e prokurorëve dhe mundësia që të marrë dhe transferojë rastet nga një prokurori në tjetrën, me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës por edhe të paanshmërisë në vendimmarrje.

Po ashtu, në përputhje të plotë me Ligjin për gjykatat, janë plotësuar dispozitat për organizimin e qartë të shkallëve të Prokurorisë në Republikën e Kosovës, duke përcaktuar ushtrimin e funksioneve në kuadër të këtyre niveleve të Prokurorisë së shtetit.

Kemi qenë të kujdesshëm që të rrisim efikasitetin dhe performansën e punës së prokurorëve duke lejuar një lloj subordinimi dhe një lloj kompetence të kryeprokurorëve të prokurorive themelore që deri më tani nuk e kanë pasur, brenda asaj zyre të kenë edhe kompetencat e transferimit dhe ricaktimit të rasteve.

Po ashtu, kemi theksuar që emërimi i prokurorëve të rinj në Republikën e Kosovës duhet të jetë fleksibil sa u përket kriterëve, por gjithmonë i harmonizuar me kriterë për gjyqtarë në Republikën e Kosovës.

Kemi thjeshtësuar procedurat për seleksionimin e prokurorëve, por duke i shtuar rolin, në veçanti të Këshillit.

Kjo është bërë në përputhje me standardet evropiane, por njëkohësisht duke pasur parasysh edhe pengesat që janë shkaktuar deri më tani, po ashtu me qëllim të rritjes së mundësisë të pjesëmarrjes së të rinjve dhe të rejave në këtë sistem.

Më lejoni të them se gjithmonë kemi qenë të kujdesshëm që avancimi në kuadër të sistemit prokurorial të Kosovës, për anëtarët e Këshillit të jetë i penguar për aq sa e kanë këtë detyrë.

Dhe krejt në fund, kemi paraparë edhe mundësitë e shkarkimit të prokurorëve për mos përmbushjen e detyrave të tyre apo obligimeve që i kanë të parapara me ligj dhe me Kushtetutë.

Ju ftoj që me vërejtje dhe sugjerime tuaja ta miratoni në parim dhe pastaj t'i bëjmë ndryshimet adekuate për lexim të dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, pas prezantimit të Projektligjit nga ana e ministrit, hapim diskutimet në parim.

Fjalën e ka kryetarja e Komisionit funksional për Legjislacion, zonja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur me 15.5.2015 e shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/225 për Prokurorinë e Shtetit dhe i rekomandon Kuvendit që ta përkrahë në parim.

Më lejoni të shfrytëzoj rastin që t'i përmendi edhe vërejtjet e Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje" për këtë projektligj.

E para, nëse e lexojmë këtë projektligj shohim se është duke u ngritur kompetenca e Kryeprokurorit të shtetit sa i përket të drejtës që të marrë lëndë, pra vetëm me një shkresë të veçantë, nën arsyetimin e rrjedhës së procedurës që ta marrë cilëndo lëndë dhe të njëjtën ta kalojë te një prokuror tjetër, ose edhe krejt te një prokuror tjetër.

Mendoj se duhet të qartësohet se çka përmban kjo shkresë e veçantë, pse cilësohet e veçantë, çka duhet të përfshihet në të.

Po ashtu, është rritur edhe autoriteti i kryeprokurorit ndaj prokurorëve të prokurorive themelore të apelit. Nuk e di, ndoshta kjo do të duhej të diskutohej edhe në dëgjimin publik që e ka organizuar Komisioni për Legjislacion dhe KDI të mërkurën në orën 12 ku do të jenë të përfaqësuar edhe grupe tjera të interesit dhe Këshilli Prokurorial dhe prokurorë të tjerë dhe ndoshta ata do të na japin opinionet e tyre se a është mirë që të fuqizohet tej mase roli i Kryeprokurorit të shtetit.

Në nenin 11, tek Kryeprokurori i shtetit, paragrafi 4. Kryeprokurori i shtetit, në bazë të një vendimi me shkrim mund të marrë nën juridiksion cilindo rast, në cilindo prokurori në Republikën e Kosovës, ose ta ricaktojë atë te një prokurori tjetër.

Pra, në këtë rast, besoj se do të duhej të ishte një vendim i arsyetuar, sepse në disa raste mund të jetë e drejtë, mirëpo në disa raste mund të keqpërdoren të drejtat e kryeprokurorit të shtetit.

Neni 13, paragrafi 7. Kryeprokurori i një prokurorie, apo cilido prokuror tjetër i ndonjë prokurorie, kryeprokurori i shtetit apo prokurori i Zyrës së kryeprokurorit të shtetit i autorizuar nga ai mund t'japë udhëzime të detyrueshme me shkrim për punën konkrete, udhëzimet e tilla mund t'u japin prokurorëve në prokuroritë që i drejtojnë dhe edhe kryeprokurorët e prokurorive.

Ne konsiderojmë se udhëzimet jepen me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, të ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit. Duhet pasur kujdes këtu në terminologji, sepse kjo mund të duket dhe të jetë në kundërshtim me parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së prokurorëve dhe duket si ndikim në punën e prokurorëve.

Pra, besoj se kjo dispozitë është e drejtë mirëpo duhet sadopak ta zbusin gjuhën në mënyrë që mos të duket si kundërshtim me parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë.

Prandaj, për këtë arsye Lëvizja "Vetëvendosje" nuk do ta përkrahë dhe vetëm për këtë problem që do ta përmendi në vijim.

Në qoftë se me këtë projektligj është rritur autoriteti i Kryeprokurorit të shtetit, në dispozitat kalimtare të këtij projektligji, në raport me EULEX-in, është e kundërta. Vetëm po e lexoj nenin 12, dispozitat kalimtare.

"Gjatë kohëzgjatjes së mandatit të EULEX-it në Kosovë, kryeprokurori i shtetit nuk mund të marrë nën juridiksion raste që i janë caktuar një prokurori të EULEX-it pa pëlqimin e kryeprokurorit të EULEX-it".

Kjo është ndër dispozitat e dëmshme të këtij projektligji dhe për këtë arsye ne si subjekt politik nuk do ta përkrahim për sa kohë ka dispozita të tilla të papranueshme dhe të padrejta.

Pra, po e degradon edhe rolin e Kryeprokurorit të shtetit, sepse nuk mundet kryeprokurori në çfarëdo rrethane, në çfarëdo rasti të marrë një lëndë pa një vendim të kryeprokurorit të EULEX-it.

Pra, kjo është arsyeja që ne nuk do ta përkrahim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën Nezir Çoçaj, nga Partia Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti ministër,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar plotësim-ndryshimin e Projektligjit për Prokurorin e shtetit.

Ne si Grup, në parim do ta mbështesim këtë projektligj dhe në punën e komisioneve do t'i paraqesim sugjerimet tona. Faleminderit!

KRYETARI: E ka fjalën Agim Ademaj, nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ndryshimet që bëhen me të në Ligjin për prokurorin e shtetit dhe qëndrojnë disa nga vërejtjet e koleges më herët, në këtë pjesën e dispozitave kalimtare, zoti ministër, te kompetenca me kryeprokurorin e EULEX-it. Nuk e di sa kemi mundësi aty që ta diskutojmë ose që të bëjmë ndonjë ndryshim, do të shohim edhe në Komision dhe në grupe punuese, por parimisht LDK-ja e përkrah këtë projektligj dhe mendojmë se pjesa dërmuese e këtij projektligji flet për kompetencat e shtuara të kryeprokurorit që besoj do të jetë pozitive, sidomos në këtë situatë në të cilën kemi pasur probleme.

Unë nuk kam diçka tjetër dhe mendoj që në komision dhe në grupe punuese LDK-ja do të angazhohet që të japë vërejtjet dhe amendamentet e veta dhe të dalim sa më mirë me këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën Donika Kadaç-Bujupi, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

DONIKA KADAÇ-BUJUPI: Faleminderit!

Edhe ne, pikërisht për shkak të nenit 12, i cili, atë që e tha ministri i Drejtësisë, që do të thotë nuk kemi pasur kompetenca të plota dhe tani do t'i kemi, në njëfarë forme e pamundëson, sepse thotë që kryeprokurori i shtetit nuk mund të marrë asnjë rast pa marrë vendimin e EULEX-it dhe ne konsiderojmë që kjo është ndoshta një mangësi për shkak të cilës pas 3 muajve, 6 muajve ose 1 muaj përsëri Qeveria jonë do të ankohet se me rastin konkret nuk kanë pasur mundësi, sepse kryeprokurori ka dështuar për shkak që s'ka pasur mundësi të trajtojë lëndë të caktuara, dhe vota për këtë projektligj do të jetë kundër, si Aleancë.

Dhe në ndërkohë, pasi që ministri është këtu, e kam një pyetje shtesë. Po flasim për sistemin e gjyqësisë në përgjithësi. Pas rasteve të fundit në Kumanovë, ka ndodhur një bastisje e 30 familjeve në mesnatë, të cilat sipas ministrit të Punëve të Brendshme dhe drejtorit të Policisë, deklarata të cilën sot e kanë dhënë zyrtarisht pranë Komisionit përkatës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kanë thënë që ata nuk e dinë mbi bazën e cilit dokument ose cili prokuror ka lëshuar urdhër që këto familje të bastisen ose mbi bazën e të cilës informatë. Madje që të dy kanë deklaruar se nuk kanë asnjë informatë se pse ka ndodhur bastisja.

Ndërkohë, ju jeni ministër i Drejtësisë dhe ata nuk paskan informatë, ndoshta ju mund të na njoftoni se mbi bazën e cilit ligj dhe cili prokuror e ka lëshuar këtë urdhër për bastisje dhe në ndërkohë paraprakisht shteti ynë nuk i ka njoftuar familjarët për çka bëhet fjalë ose ku gjenden familjarët e tyre, ose nuk e kemi asnjë informatë zyrtare për fatin e tyre. Do të thotë, thjeshtë i kanë traumatizuar anëtarët e familjes të cilët nuk guxojmë t'i paragjykojmë për shkak të veprimeve eventuale të familjarëve të tyre dhe të cilët në ndërkohë aspak nuk janë njoftuar zyrtarisht nga Qeveria e shtetit tonë se ku ndodhën të njëjtit ose për çfarë bëhet fjalë.

Pyetja është se kush është prokurori, a mund të na njoftoni në këtë Kuvend dhe pse ka ndërmarrë këto veprime për deri sa as Ministria e Punëve të Brendshme e as drejtori i Policisë nuk paska pasur informatë përkatëse.

KRYETARI: Faleminderit! Haxhi Shala, nga "Nisma", e ka fjalën!

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne si Grup Parlamentar nuk do ta përkrahim këtë projektligj. Janë shumë arsye, është edhe neni 12, ku dihet se EULEX-i është kompetent për hetimin e krimeve të luftës së fundit në Kosovë. Njëkohësisht kisha kërkuar një përgjigje nga ministri që krimet e luftës ose masakrat e 1998 kush do t'i hetojë dhe EULEX-i deri më tash nuk ka bërë asnjë hetim lidhur me masakrat e vitit 1998 gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Për këtë arsye ne nuk do ta përkrahim, përndryshe në qoftë se amendamentohet ky ligj dhe Prokuroria e Shtetit tonë të merret me hetimin e masakrave të 1998 ne do ta përkrahim në pjesën e dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Danush Ademi, nga Grupi “6+”, e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit i nderuari kryetar!

Grupi “6+” ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit dhe në parim do ta përkrahim këtë projektligj.

KRYETARI: Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe rrjedha e debatit shkon në logjikën e forcimit të sistemit të drejtësisë në vend, që ne po e quajmë tash edhe të gjyqësorit dhe të Prokurorisë. Unë mendoj që edhe në diskutimet, qofshin të grupeve parlamentare, qofshin të deputetëve, nuk duhet ta ndryshojnë as frymën as nuancat, pavarësisht amendamenteve apo kronologjisë së një amendamenti të caktuar. Dhe për këtë arsye unë parimisht jam që prokurori i shtetit të ketë autoritet, mbi të gjitha të ketë një rol të qartë jo vetëm atë të udhëheqjes administrative të Prokurorisë së Shtetit, por të jetë adresa kryesore ku kërkohet përgjegjësi për luftimin e krimit dhe të korrupsionit në vend. Dhe kjo do të na e lehtësonte punën, qoftë të legjislativit dhe qoftë të shoqërisë kosovare në përgjithësi.

Sa i përket marrjes së rasteve, ku thuhet se kryeprokurori i shtetit, në bazë të një vendimi me shkrim, mund të marrë nën juridiksion cilindo rast, në cilindo prokurori në Republikën e Kosovës, ose ta ricaktojë atë te një prokurori tjetër, unë mendoj se kjo ndërlidhet edhe me dispozitat kalimtare, ajo që është dilema mes autoritetit të EULEX-it që marrja e rastit duhet të bëhet me vendim të arsyetuar. Nëse kemi vendim të arsyetuar atëherë kjo i heq edhe dilemat e mëposhtme, qoftë marrjes së një rasti edhe nga prokuroritë tjera por edhe nga prokuroria e EULEX-it.

Te neni 14, te kompetencat dhe organizimi i prokurorit të shtetit, besoj se këtu është më shumë gabim teknik se sa amendament i cili e ka bazën e logjikës, sepse thotë - prokurori i shtetit është kompetent për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër.

Nuk ka vepra tjera, domethënë nuk ka ligj për vepra tjera, përpos dikush që dyshohet, dyshohet për ndjekje penale dhe nuk e humb logjikën dhe atë që e ka detyrë edhe prokurori i shtetit.

Te një nen i caktuar që ka të bëjë me parimet e përgjithshme, te neni 1.6, që po lidhet edhe me Ligjin për gjykatat, por edhe me përzgjedhjet e tjera, është që të mos jetë i dënuar për veprë penale.

Unë pajtohem plotësisht se duhet të kemi pastërti qoftë të prokurorëve e qoftë të gjyqtarëve por kemi edhe disa vepra penale që me vendim të gjyqësorit final janë të kryera nga pakujdesia. Për shembull, po e zë ad hoc, një veprë penale në komunikacion një prokuror i cili ushtron detyrën 15 vjeçare ose më tepër në institucionin, qoftë të Prokurorisë qoftë të gjyqësorit dhe ai me këtë amendament mund të parashtrohet. Prandaj mendoj se duhet të shënohet - përveç veprave penale të kryera nga pakujdesia e cila kualifikohet me vendim përfundimtar gjyqësor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë fjalën e ka ministri i Drejtësisë, zoti Hajredin Kuçi. Pra, derisa e merr ministri fjalën, të qëndrojmë pak më larg të drejtësisë e mos të marrim akuza në interferencë, se nuk mund të interferojmë për të treguar se kush është prokurori, thjeshtë. Mirëpo, familjarët kanë të drejtë. Familjarët kanë të drejtë ta kenë parasysh. Kanë të drejtë të kërkojnë kush.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni për dy-tri çështje që u theksuan këtu t'u jap përgjigje, e që u ngritën edhe nga çështja e zonjës Haxhiu, lidhur me rastet kur prokurori i shtetit nuk mund t'i marrë ato që janë në kompetencë të EULEX-it. Këtu kemi të bëjmë me rastin që kanë filluar para 15 prillit të vitit të kaluar dhe të cilat po ashtu mund të zgjasin deri më 15 qershor të vitit që do të vjen, por jo për raste të tjera, nga se rastet e tjera po ashtu EULEX-i nuk mund t'i marrë pa pëlqimin e prokurorëve të prokurorive kompetente.

Sa i përket çështjeve që i ngriti zoti Shala, për krimet e luftës, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka themeluar një Departament, në mbledhjen e kaluar, që do të jenë 3 prokurorë vendorë që do të merren me këtë çështje tash dhe në të ardhmen.

Të vetmin problem e kemi që shumica e atyre që kanë kryer krime të luftës nuk janë fizikisht në Kosovë dhe sipas ligjeve tona nuk mund të gjykohen në mungesë fizike, por Këshilli Prokurorial do ta kryejë punën e vet.

Për çështjen e fundit, besoj se përgjigjen adekuate e dha edhe kryetari i Kuvendit. Unë kam marrë vesh nga mediat, besoj sikur të gjithë të tjerët. Por, mund të them një, është çështje që përmes avokatëve secila palë ka të drejtë që të njoftohet për atë. Faleminderit!

KRYETARI: Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Mirë, po çohem në këmbë. Prokurori ka dhënë urdhër, mbi të cilat informata në rast se ministri i Punëve të Jashtme dhe drejtori i Policisë nuk posedon asnjë lloj informacioni. Kush është ai prokuror, mbi çfarë informacionesh, se je ministër i Drejtësisë, i ka bastisur familjet hala pa i marrë informatat që i kanë djemtë e vvarë.

Pse jeni shkuar në 3 të natës? Çfarë rregulli ka? A keni kod moral, etik a qysh guxoni t'iu shkoni njerëzve pa ua dërguar informatën zyrtare. E dimë që duhet certifikata e vdekjes. Pse keni shkuar dhe i keni bastisur? A keni marrë urdhër prej kryeministrit maqedon, a prej kujt?

Këto përgjigje duhet t'ia jepni popullit.

KRYETARI: Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Shiko, zoti Haradinaj. Unë u shpreh ngushëllime atyre që kanë vdekur atje, që kanë rënë dhe më duhet të them po ashtu se është jo logjike që ministri i Drejtësisë të di kush jep urdhër. Unë po e them kështu. Dhe po ashtu nuk përgjigjem unë për Policinë dhe për Ministrinë e Brendshme. Atë duhet ta them shumë qartë.

Por, po e them me përgjegjësi të plotë, edhe politike, edhe njerëzore, morale dhe kombëtare: unë kam marrë vesh nga mediat.

KRYETARI: Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Duke dëgjuar prononcimet e ministrit që thotë për gjykatën, e cila do të formohet për krimet e luftës dhe prokurorët të cilët do të punojnë në atë drejtim, dhe thotë se shumica e rasteve ose rastet nuk janë këtu nëse ngritën aktakuzat.

Unë mendoj se është e palejueshme në drejtësi të paragjykohet ku janë ata kriminelë të cilët kanë bërë krime të luftës brenda në Kosovë ose jashtë Kosovës, sepse nëse e dinë që janë jashtë, nuk ka nevojë të ngritet aktpadi, por të ngritet ndjekje penale ndërkombëtare, me miqtë tanë ndërkombëtarë.

Prandaj, mënyra se si ne po e ndërtojmë një sistem të jurisprudencës, të Prokurorisë, të hetuesisë, mendoj që është reflektim i një çështje që faktori vendor nuk është as me kapacitete humane, po as me përkushtimin intelektual dhe në vendimmarrje për vendime të tilla. Dhe përgjegjësia bie edhe mbi institucionet e drejtësisë së Republikës së Kosovës dhe nuk duhet të lakohet topi herë në një pozicion e herë në tjetër.

Për problemet e fundit në incidente që janë bërë, ekzistojnë metodologji të cilat duhet të ndiqen dhe të faktohen, por jo të spekulohen dhe ne nuk kemi nevojë as formale as përmbajtësore të ndejmë as dhembshuri por as të ndejmë përkushtim të radhitjes në probleme. Problemet janë shkaktuar, nuk është dhënë nota sot, nuk ka as institucione të Republikës së Kosovës që përgjegjësinë duhet ta marrin mbi vete, duke filluar nga ministri i Punëve të Brendshme, duke filluar nga komandanti i Policisë, duke filluar nga institucionet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Realisht, për këtë pikë të rendit të ditës, diskutimet kanë përfunduar. Më lejoni ta theksoj vetëm një njoftim, si kryetar i Kuvendit duke pasur parasysh se në Parlamentin tonë shpeshherë shprehet shqetësimi, veçanërisht për gjendjen e të arrestuarve.

Ne jemi duke tentuar që ta autorizojmë Këshillin për Lirinë dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut që t'i lejohet t'i vizitojë të burgosurit atje dhe në të njëjtën kohë të na e sjell një raport ne deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Ta keni parasysh, nga dita e premte, se duhet të dihet edhe publikisht, jemi në pritje të përgjigjes zyrtare nga autoritetet maqedonase. Kemi kontaktuar edhe me ambasadorin e tyre këtu edhe me autoritetet e Ministrisë së Drejtësisë atje.

Atëherë, edhe kjo pikë e rendit të ditës përfunduar. Po, urdhëro Flora Brovina, por mos ta hapim tutje si diskutim. Pra, për këtë çështje, jo. Për çështjen e Projektligjit, po që se ka replikë.

FLORA BROVINA: Vetëm desha të shtoj se përpos Këshillit të Drejtave të Njeriut, duhet edhe Kryqi i Kuq yni. Kaq!

KRYETARI: Atëherë, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës dhe kisha lutur deputetët bile para orës 13:30 të jenë këtu për votim.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kompensimin e viktimave të krimit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim dhe miratim, në parim.

E ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që të prezantoj para jush Projektligjin për kompensimin e viktimave të krimit.

Më lejoni të them se është hera e parë që në Republikën e Kosovës nxirret një projektligj i tillë, që ka paraparë të rregullohen çështjet që jo vetëm njerëzit të cilët kanë kryer krimin e mundshëm, por edhe viktimat e tyre të kompensohen.

Janë paraparë disa kategori të veprave që do të kompensohen dhe në këtë drejtim, Projektligji i ka paraparë këto vepra:

E para, është vrasja, trafikimi me njerëz, dhunimi, keqpërdorimi seksual i fëmijëve, veprat penale që bien në përkufizimin e dhunës në familje, sipas Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Po ashtu, përveç këtyre veprave penale, është paraparë edhe një mundësi që të kompensohen edhe kategoritë tjera, të cilat mund ta konsiderojnë veten viktimat të krimit të dhunshëm, por ato kanë nevojë që t'i plotësojnë kushtet formale e materiale dhe të prezantojnë çështjen e tyre para një komisioni, i cili do të jetë i përbërë. 1 gjyqtar i Gjykatës Supreme do të jetë kryetar i këtij këshilli, 1 përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, 2 anëtarë ekspertë mjeko-ligjor nga Oda e Mjekëve të Kosovës dhe 1 përfaqësues i shoqërisë civile, i propozuar nga Avokati i Popullit.

Natyrisht këtu janë paraparë edhe kompetenca e gjykatave që t'i shqiptojë taksa për raste të tilla.

Më lejoni të them se fillimisht kompensimi i këtyre viktimave do të jetë nga Buxheti i Republikës së Kosovës, respektivisht nga Ministria e Drejtësisë dhe prej viteve të tjera do të jetë një buxhet i veçantë. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, kalojmë në radhën e diskutuesve. Fjalën e ka zoti Armend Zemaj, në emër të Komisionit funksional për Legjislacion.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit kryetar!

Edhe në emër të Komisionit funksional e përkrahim në parim këtë projektligj që ka të bëjë me kompensimet e viktimave të krimit. Ky projektligj mbulon çështjet që rregullojnë fushën e kompensimit të viktimave të krimit në Kosovë, konform obligimeve që janë nga legjislacioni vendor i Kodit të Procedurës Penale, por edhe ai ndërkombëtar.

Njëherit, edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, i japim përkrahje në parim. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, Selviqe Halimi e ka fjalën.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah Projektligjin për kompensimin e viktimave të krimit dhe përgëzojmë ministrin që e ka sjell në sistemin e drejtësisë në Kosovë një ligj të tillë.

KRYETARI: Faleminderit! Për Lëvizjen “Vetëvendosje”, e ka fjalën zonja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Atëherë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Projektligjin për kompensimin e viktimave të krimit dhe ne do ta përkrahim në parim këtë projektligj, mirëpo më duhet të them se nëse e lexojmë këtë projektligj lë shumë hapësira për interpretime dhe besoj se Komisioni për Legjislacion do të duhej t'i definonte se cilat janë të drejtat dhe përgjegjësitë edhe të Komisionit, mirëpo edhe të palëve karshi të drejtave të tyre.

Sa i përket përbërjes së këtij Komisioni për kompensim të viktimave, thuhet që do të jetë përbërja nga 1 gjyqtar i Gjykatës Supreme, 1 përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, 2 anëtarë ekspertë në fushën e traumatologjisë dhe psikiatrisë dhe 1 anëtar nga Shoqëria Civile, i propozuar nga Avokati i Popullit.

Unë besoj që edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës gjegjësisht Komisioni për Legjislacion do të duhej që ta kishte anëtarin e vet në këtë Komision e gjithashtu do të duhej të ishte vetë Avokati i Popullit pjesë e këtij Komisioni.

Pra, mendoj se kjo do të duhej të adresohet gjatë punimeve në fazën e shqyrtimit në Komisionin për Legjislacion.

Pra, në parim Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” konsideron se është e domosdoshme që të miratohet dhe do ta përkrahim në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën Shukrije Bytyqi, nga Grupi Parlamentar “Nisma”.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar Nisma për Kosovën e ka shqyrtuar Projektligjin për kompensimin e viktimave të krimit. Vërtet ky projektligj është më se i nevojshëm dhe është i vonuar. Ne me kohë do t’i dërgojmë vërejtjet dhe amendamentet në Komisionin përkatës, se ky projektligj përmban vërejtje teknike dhe përmbajtjesore dhe ne me kohë do t’i përgatisim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit. Kujtim Paçaku, nga “6+”, e ka fjalën.

KUJTIM PAÇAKU: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” në parim do ta përkrahë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën Teuta Haxhiu nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Gjithashtu e mora fjalën për ta dhënë edhe një herë përkrahjen, pra të Grupit tonë Parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka diskutues tjerë. Edhe më herët janë ftuar të jenë këtu deputetët. I kemi 66 deputetë në sallë.

Të nderuar deputetë, në vazhdim duhet të deklarohe mi me votim për miratimin në parim të këtyre projektligjeve dhe do të shkojmë me këtë Projektligjin, të cilin tani e trajtuam për kompensimin e viktimave të krimit.

Them edhe një herë se 66 deputetë janë në sallë. Nëse ka tjerë, i kisha lutur të vijnë.

Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim në parim të Projektligjit për kompensimin e viktimave të krimit. Votojmë tash!

65 deputetë kanë votuar, me 65 vota për.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për kompensimin e viktimave të krimit.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandime për seancën plenare e cila do të mbahet me 28 maj 2015.

Jemi tek shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të këtij projektligji. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

68 deputetë kanë votuar, 66 për dhe 2 abstenime.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime për seancën plenare e cila do të mbahet me 28 maj 2015.

Kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Votojmë tash!

68 deputetë kanë votuar, 67 për dhe kemi vetëm 1 abstenim.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime për seancën plenare e cila do të mbahet me 28 maj 2015.

Kërkohet miratimi në parim nëpërmjet deklarimit me votim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

71 deputetë kanë votuar. 53 janë për dhe 15 kundër, me 3 abstenime.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime për seancën plenare e cila do të mbahet me 28 maj 2015.

Me këtë i mbyll punimet e seancës së sotme. Mirupafshim në seancën e radhës. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*